

Kapitulli i Parë

Ekonomia: Zhvillimet dhe Politikat

Përmbajtja

1. EKONOMIA BOTËRORE.....	8
2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO	12
3. KURSIMET DHE INVESTIMET.....	15
4. PUNËSIMI DHE TË ARDHURAT.....	18
4.1 TREGU I PUNËS.....	18
4.2 PUNËSIMI SIPAS SEKTORËVE.	21
4.3 TË ARDHURAT.....	22
5. ÇMIMET E KONSUMIT DHE INFLACIONI.....	24
5.1 FAKTORËT E POLITIKAVE EKONOMIKE.	25
5.1.1 <i>Politika fiskale.</i>	25
5.1.2 <i>Politika Monetare.</i>	26
5.2 ZHVILLIMET NË INDEKSIN E ÇMIMEVE TË KONSUMIT.....	27
6. DEFICITI BUXHETOR.....	31
7. BILANCI I PAGESAVE DHE REZERVA VALUTORE	33
7.1 ZHVILLIMET NË LLOGARINË KORENTE DHE BILANCIN E PAGESAVE.	33
7.2 ADMINISTRIMI I REZERVËS VALUTORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË.....	37

Fjala Guvernatorit,

Kam kënaqësinë të paraqes Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 1999. Raporti trajton zhvillimet në ekonominë shqiptare, në fushën monetare dhe të këmbimeve valutore, të mbikëqyrjes bankare, të sistemit të pagesave etj..

Për herë të parë nga krijimi, Banka e Shqipërisë raporton gjendjen e saj financiare të shoqëruar me opinionin e kontrollorit të jashtëm të pavarur. Ky është një hap i rëndësishëm në rritjen e transparencës së veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë dhe në respektimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e kontabilitetit dhe të llogaridhënies.

Viti 1999 trashëgoi një situatë ekonomike relativisht të qëndrueshme nga viti 1998. Objektivat për vitin 1999 u përcaktuan ambiciozë, nisur nga nevoja që ka Shqipëria për një zhvillim të shpejtë. Situata e luftës në rajon, megjithatë, nuk çënoi arritjen e objektivave sasiore. Aktualisht, thuhet me bindje se edhe gjatë vitit 1999 ekonomia shqiptare u zhvillua brenda kuadrit të programuar. Në këtë mënyrë, viti që kaluam kontribuoi në rritjen e qëndrueshmërisë ekonomike të vendit.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë iu përshtat zhvillimeve në inflacion, në vlerën e monedhës së vendit, në ecurinë e depozitave si dhe nevojës së vendit për financim dhe për të mbështetur rritjen ekonomike. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë reagoi me zbutje të politikës monetare duke ulur vazhdimisht normën e interesit. Nga ana tjetër, nuk u prek angazhimi për respektimin e objektivave monetare sasiore. Pavarësisht nga kjo, sistemi bankar nuk plotësoi nevojat e ekonomisë me kreditim. Kreditimi, megjithë heqjen e kufirit të kreditit, mbeti në nivele minimale.

Politika fiskale, gjithashtu, ishte hartuar në funksion të reduktimit të deficitit buxhetor, e cila kontribuoi në uljen e normës së inflacionit. Disiplina fiskale u forcua më tej, e konfirmuar në rradhë të parë nga respektimi i objektivave për deficitin buxhetor, sidomos deficitin buxhetor të financuar me burime të brendshme. Megjithatë, gjatë vitit që shkoi përsëri u evidentua një reduktim në grupin e shpenzimeve kapitale ndërkohë që dhe aritmia në kryerjen e shpenzimeve ishte e pranishme. Për të mos kompromentuar politikën monetare, çënuar arritjen dhe ruajtjen e stabilitetit të çmimeve si dhe arritur objektivat ekonomikë në të ardhmen, është e nevojshme që të forcohet më tej koordinimi i punës midis qeverisë dhe Bankës së Shqipërisë.

Zhvillimet në sektorin e jashtëm, sidomos hyrjet e mëdha në mallra dhe valutë gjatë periudhës së konfliktit, çuan në një rritje relativisht të madhe të rezervës valutore dhe në një tendencë të qartë në mbiçmimin e monedhës kombëtare.

Në tërësi, zhvillimet e vitit 1999 vlerësohen si vazhdimësi e zhvillimeve të vitit 1998. Në këtë kuptim mund të themi që jo pak nga mangësitë dhe dështimet e vitit 1998 qenë të pranishme dhe në vitin pasardhës. Megjithë përmirësimet e vërejtura, nuk u realizua pretendimi për rritjen e investimeve, zhvillimin e reformave institucionale, sigurimin e rendit dhe të qetësisë, luftën kundër korrupsionit dhe kontrabandës, forcimin e zbatimit të ligjit dhe të sistemit gjyqësor, privatizimin e ekonomisë si dhe rritjen e punësimit. Këta janë faktorë të mjaftueshëm për ta vlerësuar stabilitetin makroekonomik të arritur ende të pakonsoliduar.

Shkëlqim Cani

Guvernator

Kapitulli i Parë

Ekonomia: Zhvillimet dhe Politikat

Në fillim të dekadës së viteve '90 të shekullit të kaluar, Shqipëria filloi transformimin politik, ekonomik, shoqëror etj., drejt ekonomisë së tregut, me qëllim final integrimin e vendit në strukturat ndërkombëtare politike, ekonomike, ushtarake e kulturore, me theks të veçantë integrimin në Bashkimin Europian. Parimet bazë ku do të përqendrohej programi i transformimit përfshinin liberalizimin dhe privatizimin e ekonomisë, të mbështetur në një terren makroekonomik të qëndrueshëm.

Në vitet e tranzicionit, Shqipëria ka patur mjaft zhvillime pozitive, por edhe mjaft dështime. Vitet '90 të shekullit të kaluar përvijohen nga dy periudha, në të cilat fenomenet e vërejtura janë përsëritur me të njëjtën skemë veprimi, ndonëse me përmasa të ndryshme. Në të dyja këto periudha (vitet 1991-1995 dhe 1996-1999) është evidentuar fenomeni "shthurje-stabilizim".

Në të dyja rastet, rënia e madhe ekonomike, përsheptimi i inflacionit, thellimi i deficitit korent, në përgjithësi kriza ekonomiko-financiare është vënë nën kontroll nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të programeve emergjente gjashtëmujore.

Për konsolidimin dhe ruajtjen e stabilitetit në periudha më afatgjata janë hartuar programet afatmesme trevjeçare thelbi i të cilave qëndronte në kryerjen e reformave të thella strukturore, ligjore, institucionale dhe administrative, të cilat do të siguronin kushtet për konsolidimin e arritjeve në fushën makroekonomike (rritje relativisht e lartë ekonomike, inflacion i ulët, vendosje e disiplinës fiskale e monetare etj.).

Megjithatë, pas një dekade tranzicioni politik, ekonomik dhe social, shoqëria shqiptare hyri në mijëvjeçarin e ri me mjaft ngarkesa dhe e ballafaquar me një mori problemesh të mprehta. Shqipëria nuk arriti të jetë e suksesshme në zbatimin e pjesës më të rëndësishme të programit afatmesëm të zhvillimit, në kryerjen e reformave të thella strukturore, institucionale, ligjore dhe administrative. Pikat më të dobta të periudhës së tranzicionit mund të përmbliidhen në një qeverisje të dobët, në mungesën e transparencës dhe të llogaridhënies (përgjegjshmërisë), në ekzistencën e evazionit fiskal të konsiderueshëm, në shkallën e lartë të korrupsionit dhe të kontrabandës. Të gjitha këto fenomene penguan konsolidimin e demokracisë dhe të shtetit në Shqipëri, rrjedhim i të cilave ishte kriza e vitit 1997.

Pavarësisht nga përpjekjet e bëra gjatë dy viteve të fundit, aktualisht ekonomia shqiptare vuan ende nga mangësi strukturore, nga një qeverisje e pakonsoliduar si dhe nga probleme që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit dhe forcimin e rendit e të sigurisë.

Gjatë vitit 1998, u arrit të rivendoseshin ekuilibrat makroekonomikë, u sigurua një rritje e shpejtë ekonomike prej 8 për qind në vit, ndërkohë që inflacioni ra në 8.7 për qind nga 42 për qind që rezultoi në fund të vitit 1997. Rivendosja e ekuilibreave u mundësua, në shkallë të madhe, nga zbatimi i një politike të shtrënguar dhe të matur monetare e fiskale si dhe nga forcimi dhe përmirësimi i bazës ligjore. Të dyja politikat ishin në funksion të vendosjes nën kontroll të inflacionit nëpërmjet respektimit rigoroz të objektivave sasiorë monetarë dhe kufijve të financimit buxhetor.

Ecuria e ekonomisë shqiptare në vitin 1999, parë nga një këndvështrim i përgjithshëm, mund të vlerësohet si një proces vazhdimësie i arritjeve të vitit paraardhës. Elementi kryesor i programit të këtij viti mbeti ruajtja e stabilitetit të nivelit të çmimeve. **U parashikua, që në fund të vitit, inflacioni të reduktohej në masën 7 për qind, në kushtet kur synohej një rritje ekonomike e vendit në masën 8 për qind. Stabiliteti fiskal do të konsolidohej më tej duke kufizuar deficitin buxhetor të financuar me burime të brendshme në 5.9 për qind të PBB-së.**

Thellimi i reformave strukturore, për vetë ecurinë jo të mirë të tyre gjatë vitit 1998, u gjykua vendimtar për sigurimin e jetëgjatësisë së arritjeve të politikave makroekonomike. Prioritetet konsistonin në: shpejtimin e privatizimit (përfshirë edhe bankat shtetërore); përfundimin e procesit të transparencës së shoqërive piramidale; reduktimin e punonjësve të sektorit buxhetor në 130 000 në fund të marsit 1999; forcimin e kuadrit ligjor, rregullator dhe mbikëqyrës në të cilin veprojnë bankat dhe të masave në drejtim të luftës kundër kontrabandës dhe korrupsionit.

Acarimi në ekstrem i konfliktit në Kosovë, shpërngulja masive me dhunë e popullsisë së atij rajoni dhe përballimi i një numri tepër të madh të ardhurish (që menjëherë arriti në 15 për qind të popullsisë së vendit), si dhe paqartësia mbi zhvillimet e mëtejshme të këtij konflikti, që ekzistoi në fillim të tij, krijoi përshtypjen se do të ishte e vështirë të zbatohej programi ekonomik për vitin 1999.

Megjithë pasigurinë që karakterizoi ekonominë shqiptare në fillimet e krizës, në bashkëpunim me faktorin ndërkombëtar, u arrit të evitoheshin në një shkallë të madhe pasojat e saj (shih box.2). Zhvillimet makroekonomike mbetën brenda kuadrit të programuar.

Të dhënat më të fundit tregojnë për një rritje të mëtejshme ekonomike në masën 8 për qind, ndërkohë që inflacioni ra në nivele të papara ndonjëherë gjatë gjithë dekadës së fundit. Rritja e mëtejshme e prodhimit ka kontribuar dhe në rritjen e të ardhurave për frymë të popullsisë, të cilat të shprehura në terma të monedhës amerikane vlerësohen të jenë në kuotën 1100 dollarë amerikanë në vit.

Viti 1999, shënoi zhvillime të pazakonta përsa i përket ecurisë së çmimeve të konsumit. Përtej çdo parashikimi, edhe atij më optimist, **norma vjetore e inflacionit në fund të muajit dhjetor regjistroi, për herë të parë, një ndryshim negativ, në masën -1.03 për qind.** Megjithatë, norma mesatare e inflacionit për gjithë vitin 1999, rezulton të jetë pozitive ndonëse përsëri në nivele shumë të ulëta, vetëm 0.4 për qind. Të dyja politikat, si fiskale ashtu edhe ajo monetare, kanë qenë në përputhje me angazhimet dhe për rrjedhim efektet e tyre kanë pasur ndikim pozitiv në ecurinë e inflacionit. Nga ana tjetër, prurjet e mëdha në mallra dhe në valutë që Shqipëria thithi gjatë vitit 1999, kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në kursin e këmbimit, duke kontribuar direkt edhe mbi stabilitetin e çmimeve. Gjithësesi, sfida për të ardhmen mbetet stabilizimi i tij për periudha më afatgjata.

Tabela 1. Tregues Ekonomikë të Përgjithshëm.

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Popullsia (000)	3190.1	3167.5	3202.0	3248.8	3283.0	3324.3	3354.3	3387.8
Përqindja e rritjes së popullsisë	-2.1	-0.7	1.1	1.5	1.1	1.3	0.9	1.0
Numri i të punësuarve (000)	1095.0	1046.0	1161.0	1138.0	1116.0	1107.0	1103.0	1085.0
PBB (çmime korente, milionë Lekë)	50697	125340	187891	224745	280998	341716	460631	506205
PBB (çmime korente, milionë USD)	673	1222	1984	2422	2689	2294	3058	3676
PBB për frymë (në USD)	211.0	385.7	619.8	745.5	819.1	690.2	911.6	1121.9
Rritja në % e PBB (çmime të 1990)	-7.2	9.6	8.3	13.3	9.1	-7.0	8.0	7.3
Përqindja e papunësisë	26.5	22.3	18.4	13.1	12.4	14.9	17.8	18.0
Përqindja e inflacionit (v/v)	236.6	30.9	15.8	6.0	17.41	42.1	8.7	-1.0
Llog. Korente (në % të PBB-së) 1/		-28.8	-14.3	-9.7	-11.5	-14.4	-8.2	-9.3
Rezervat valutore (milionë USD)			204.6	240.3	280.0	308.3	384.2	481.6
Rezervat valutore (në muaj importe)			3.1	3.7	3.1	4.6	4.9	5.2
Borxhi brendshëm (në % të PBB-së)				25.1	30.7	35.8	32.9	34.0
Borxhi jashtëm (në % të PBB-së)			52.5	30.4	29.2	35.6	26.5	25.4

1/ Llogaria korente përjashtuar të ardhurat neto nga faktorët e shërbimeve dhe transfertat shtetërore.

Burimi: INSTAT, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë dhe vlerësime të FMN-së.

Rezervat valutore të Bankës së Shqipërisë, u rritën më tej gjatë vitit 1999, duke mundësuar që vendi të përballojë 5.2 muaj importe mallrash dhe shërbimesh. Llogaria korente gjatë vitit 1999 u mbyll në nivelin 4.1 për qind të PBB-së, rreth 2.6 pikë përqindjeje më shumë se viti i mëparshëm. Në një pozicion pak a shumë më të favorshëm paraqitet dhe borxhi i jashtëm i vendit, i cili në fund të vitit 1999, vlerësohet të zërë 25,4 për qind të PBB-së. Gjatë gjithë vitit 1999, Leku qëndroi stabël me një tendencë të qartë mbiçmimi, i diktuar në masën më të madhe dhe nga hyrjet e mëdha valutore të vitit të kaluar.

Mbështetur në të dhënat zyrtare për punësimin, nënvizojmë faktin se tregu i punës vazhdon të karakterizohet nga një rënie e mëtejshme. Megjithëse në nivele shumë të ulëta, përqindja e papunësisë gjatë vitit 1999 u rrit më tej duke u ndalur në nivelin 18 për qind. Në anën tjetër, të ardhurat kanë pësuar po një rritje të lehtë, ku diçka më e saktë mund të thuhet për pagën mesatare të sektorit publik, e cila gjatë vitit 1999 u rrit me 32 për qind¹ në terma realë krahasuar me një vit më parë.

Aplikimi i të dyja politikave bazë, asaj fiskale dhe monetare, rezultoi i efektshëm, megjithë vështirësitë e imponuara nga kriza në rajon. Edhe pse politika fiskale u vu përballë një rreziku objektiv për të devijuar nga shtegu i programuar, falë ndihmës dhe angazhimit serioz të komunitetit ndërkombëtar, ky rrezik u mënjanua dhe, sipas të dhënave më të fundit, u arrit që deficitet buxhetor të mbahet nën kufijtë e programuar. Megjithatë, përveç panikut të momentit, që ndihmoi në uljen e të

¹ Burimi INSTAT.

ardhurave fiskale, një problem gjithnjë e më shqetësues mbetet mosrealizimi i shpenzimeve për investime, pasojat e të cilit bëhen të prekshme në një afat më të gjatë, si edhe kryerja joritmike e shpenzimeve buxhetore.

Box 1. Statistikat në Shqipëri.

Treguesit realë të ekonomisë vazhdojnë të vuajnë varfërinë e të dhënave. Për fat të keq, edhe gjatë vitit që kaloi, nuk u mundësua monitorimi i zhvillimeve të sektorit privat të ekonomisë. Edhe pse pranohet se pesha e sektorit privat është bërë mbizotëruese në tërësinë e prodhimit kombëtar, përsëri, të dhënat për të janë shumë të varfëra dhe duket se ato do të vazhdojnë të mungojnë edhe për të ardhmen e afërt dhe ndoshta më gjatë.

Megjithëse ka kaluar një periudhë dhjetëvjeçare, për shkaqe jo shumë objektive, vendi vazhdon të mos ketë asnjë lloj statistike të vlefshme për llogaritë kombëtare. Kjo mungesë të dhënash sa vjen e më shumë po krijon vështirësi për gjithë specialistët dhe vendimmarrësit, të cilët, në përgjigje, vazhdojnë të përdorin metoda vlerësimi, gjykime dhe opinione.

Në tërësi vlerësohet se gjendja e statistikave në Shqipëri është e mjerueshme. Statistikat nuk përgatiten në kohë, nuk janë të plota dhe të sakta. Ky fenomen tashmë është kthyer në pengesë për procesin e analizës, kryerjes së parashikimeve dhe marrjes së vendimeve të vlefshme për ekonominë shqiptare.

Politika monetare me kah zbutës, e nisur që nga fundi i vitit të kaluar, vazhdoi gjatë gjithë vitit 1999, duke reflektuar ndjekjen nga afër të zhvillimeve kryesisht në çmimet e konsumit, por edhe të ecurisë së vlerës së monedhës shqiptare, ecurisë së depozitave apo faktorëve psikologjikë. Ajo u karakterizua nga ulje të njëpasnjëshme të përqindjes së interesit për depozitat me afat në lekë në bankat me kapital shtetëror. Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë arriti t'i përmbahet të tre objektivave sasiore të vendosur, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në menaxhimin e kërkesës së brendshme në ekonomi.

Box 2. Kriza e Kosovës dhe ndikimet e saj.

Periudha e konfliktit në Kosovë, që përkon kryesisht me tremujorin e dytë të vitit 1999, u karakterizua nga një paqartësi lidhur me parashikimin e ngjarjeve që do të ndodhnin dhe me një precipitim të menjëhershëm të tyre. Konflikti, që filloi në javën e fundit të muajit mars, u shoqërua me një dëbim masiv të popullsisë shqiptare të Kosovës, e cila u drejtua kryesisht për në Shqipëri. Brenda një periudhe prej dy javësh, popullsia e Republikës së Shqipërisë u shtua me 15 për qind. Nga ana tjetër, mungesa e infrastrukturës përkatëse dhe e stabilitetit në vend, në vitet e fundit, e vështirësuan më tej detyrën e përballimit të kësaj situatë, e cila, në mjaft raste, arriti edhe në ballafaqimin me konflikt të armatosur me trupat ushtarake të ish-Jugosllavisë.

Megjithatë, administrimi i situatës u realizua mjaft mirë si pasojë e ndihmës dhe e mbështetjes që u ofrua menjëherë nga komuniteti ndërkombëtar, angazhimit të qeverisë dhe të vetë popullit shqiptar. Jo vetëm kaq, por përgatitjet u arritën të kryeshin për të pritur edhe një numër më të madh të shpërngulurish dhe për t'i mbajtur ata për një kohë relativisht të gjatë, që kapërcente kufirin e vitit 1999.

Edhe pse besohej se konflikti do të vazhdonte deri në fund të vitit 1999, se popullsia e shpërngulur do të qëndronte në Shqipëri të paktën deri në gjysmën e parë të vitit 2000, përsëri ngjarjet morën kthesë të papritur. Nënshkrimi i marrëveshjes së paqes u pasua me një kthim të menjëhershëm të të gjithë të ardhurve nga Kosova për në trojet e tyre. Këto kthesa të papritura përmbysnë dhe hamendjet, parashikimet dhe pritshmëritë e bëra më parë.

Sipas vlerësimeve të organizmave të ndryshme², konflikti në Kosovë dha ndikime negative në perspektivat ekonomike të Europës Juglindore. Kështu, sipas një studimi të WIIW, vlerësohet që kostoja e konfliktit, e shprehur në raport me PBB-në, për disa vende të jetë: për ish-Jugosllavinë 28 për qind; për Bosnje-

² EBRD, Transition Report, - Ten years of transition, 1999, fq.82-86.

Hercegovinën dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë 5 për qind; për Bullgarinë dhe Shqipërinë 2 për qind dhe për Kroacinë 1 për qind. Një studim i Komisionit Europian prezanton një llogaritje të kostos totale humanitare në përballimin e krizës humanitare, duke përfshirë dhe mbështetjen buxhetore për vendet e prekura nga kriza, që llogaritet nga 340 në 780 milionë dollarë. Ndërsa një studim i FMN-së e llogarit atë në shifrat 400-760 milionë dollarë. Studimi i Komisionit Europian vlerëson që kostoja e rindërtimit të Kosovës të jetë 2-3.5 miliardë dollarë, ndërsa kostoja totale e rindërtimit të të gjithë rajonit të Ballkanit Jugor të jetë rreth 30 miliardë dollarë³.

Duke ju kthyer edhe një herë konfliktit, do të veçojmë fushat ku u mendua se do të ndikonte ky konflikt dhe ç'ndodhi në realitet.

- ◆ Një nga vështirësitë më të mëdha në momentet e fillimit ishte mungesa e një infrastrukture të përshtatshme sociale dhe ekonomike për të pritur qindra mijëra njerëz të shpërngulur me forcë nga trojet e tyre. Ky moment, përveç konfuzionit që krijoi, shkaktoi dhe një kosto për Shqipërinë.
- ◆ Vënia në dispozicion të trupave të huaja ushtarake dhe organizmave të tjera ndërkombëtare e një pjese të infrastrukturës ekzistuese në Shqipëri, si Porti i Durrësit, Aeroporti i Rinasit, apo furnizimi me energji elektrike i kampeve, bëri që ekonomisë shqiptare t'i mungonin të ardhurat, që normalisht janë siguruar nga aktiviteti i këtyre objekteve.

Në aspektin rajonal, konflikti shkaktoi një ndërprerje të marrëdhënieve tregtare ndërmjet ish-Jugosllavisë dhe shteteve të tjera ballkanike. Në rastin e Shqipërisë kjo nuk përbënte problem sepse prej vitesh marrëdhëniat tregtare me këtë vend ishin tejet të kufizuara për të mos thënë inekzistente.

- ◆ Kriza, në mënyrë të drejtpërdrejtë, ndikoi në besimin e investitorëve të huaj, të interesuar për vendet e rajonit, si dhe në sektorin e turizmit. Edhe në këtë rast, humbjet që pati Shqipëria nuk ishin të konsiderueshme. Edhe pa këtë konflikt Shqipërisë i kishin munguar si investimet ashtu dhe turistët. Megjithatë, prania e trupave ushtarake, gazetarëve, punonjësve të organizatave ndërkombëtare etj., i dhanë impuls sektorit të shërbimeve.
- ◆ Nga tërësia e rrjedhojave që njohu realiteti ekonomik e politik i rajonit, pasoja më e dukshme negative është ajo që ka të bëjë me shtyrjen ose me ngrirjen e reformave strukturore dhe procesit të privatizimit. Shqipëria, në këtë mënyrë, ka pësuar një humbje afatmesme pasi pasojat e kësaj ngrirjeje do të ndikojnë në të ardhmen në arritjen e objektivave për zhvillimin e vendit.
- ◆ Ndërkohë, Shqipëria besohet se ka fituar në planin moral e historik. Së pari, kjo ngjarje e dhimbshme ndikoi në përmirësimin e imazhit të vendit tonë të tronditur mjaft nga ngjarjet e vitit 1997. U shtua interesimi i organizmave të ndryshme rajonale e ndërkombëtare apo i shteteve të tjera dhe u shpreh hapur mbështetja për zhvillimin e mëtejshëm të Shqipërisë.

Pra, konflikti në Kosovë pati ndikime shumë komplekse, të cilat u administruan me sukses dhe madje ekonomia kombëtare pati disa përmirësime në krahasim me periudhën para shpërthimit të krizës.

Respekti që fitoi Shqipëria gjatë periudhës së konfliktit, për mënyrën se si ajo trajtoi këtë krizë, i jep mundësi që ta shndërrojë këtë precedent të paparë në një avantazh ekonomik e politik për të ardhmen. Problemi që shtrohet tashmë është nëse do të jemi të aftë t'i shfrytëzojmë këto avantazhe dhe të mos vonohemi përsëri. Përgjigja e kësaj pyetjeje është e vështirë, pasi këtu ndërthuren shumë faktorë politikë, ekonomikë, socialë, kulturorë etj.. Por, është e tepërt të thuhet që këtu duhet të përqendrohen të gjitha aftësitë dhe përpjekjet e autoriteteve shqiptare si dhe të vetë popullit shqiptar.

³ Shih: Stephan Barisitz, "The Southeast European Non-associated Countries – Economic Developments, the Impact of Kosovo Crisis and Relations with the EU", in Focus on Transition I/1999, Oesterreiche NationalBank.

1. EKONOMIA BOTËRORE

Perspektivat e ekonomisë botërore u bënë më optimiste gjatë vitit 1999. Kërkesa dhe prodhimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës i tejkaloi parashikimet e bëra për vitin 1999 dhe pritjet flasin për ekspansion të mëtejshëm. Aktiviteti në zonën e euro-s gjatë tremujorit të fundit u rrit më shpejt se ç'pritej dhe ka të ngjarë që treguesit bazë të vazhdojnë të ringjallen më tej, edhe pse Euro ka ulur vlerën e saj në krahasim me Dollarin Amerikan dhe Sterlinën Angleze. Ekzistojnë shenja të pakta për rigjallërimin e kërkesës së brendshme në Japoni, por nga ana tjetër aktiviteti ekonomik dhe ai tregtar në tregjet e Azisë ka regjistruar rritje të shpejtë.

Viti 1999 në fundin e tij shënoi rritje të çmimit të disa mallrave ku veçojmë rritjen e çmimit të naftës, nivel i cili nuk ishte regjistruar që nga viti 1991. Mbështetur në pritshmërinë për një rritje të mëtejshme të kërkesës agregate, e cila mund të ndikojë në përsheptimin e inflacionit, një numër bankash qendrore, përfshirë Rezervën Federale dhe Bankën Qendrore të Europës, kanë filluar, që nga muaji i parë i vitit 2000, të aplikojnë masa shtrënguese.

“Mjegulla” që rrethoi parashikimet e zymta për zhvillimet e ekonomisë botërore në fillimet e vitit të kaluar, i la vendin një panorame më të qartë dhe optimiste në mesin e vitit 1999, kur shenjat e krizave në shumë nga ekonomitë në zhvillim filluan të marrin një kahje pozitive.

Prodhimi botëror parashikohet⁴ të rritet me 3 për qind (3/4 për qind më shumë nga parashikimi i dhënë në pranverën e këtij viti), që do të thotë 0.5 për qind më shumë nga rritja reale e realizuar gjatë vitit 1998.

Ky përmirësim pasqyron arritjet më të mira nga parashikimet e bëra për ekonomitë e goditura nga kriza. Rënia e thellë që përfshiu ekonomitë aziatike u pasua nga një rritje më e fortë nga parashikimi; kriza monetare e Brazilit u ndalua më shpejt; ekonomia ruse e rimori veten në sajë të rritjes së çmimeve të naftës dhe një ndikimi të favorshëm të zhvlerësimit të rublës në prodhimin e brendshëm dhe në tregtinë e jashtme. Hyrjet e kapitaleve private në ekonomitë në zhvillim u stabilizuan në 136 miliardë dollarë, në të njëjtin nivel të shënuar gjatë vitit të mëparshëm⁵. Megjithatë, hyrjet kapitale vazhdojnë të mbeten në gjysmën e hyrjeve vjetore të shënuara në periudhën 1995-1997.

Motori kryesor i rritjes së prodhimit botëror, edhe gjatë këtij viti, vazhdoi të mbetet forcimi i ekonomisë amerikane, e cila pritet të shënojë një rritje prej 3.7 për qind kundrejt vitit të kaluar. Faktori kryesor i kësaj rritjeje shihet tek forcimi i kërkesës së brendshme, veçanërisht nga sektori privat. Po kështu, faktorë të rëndësishëm kontribues konsiderohen zgjerimi i shpejtë i investimeve fikse dhe i stokut të kapitalit si dhe progresi i shpejtë teknik. Rritja konsiderohet e admirueshme edhe për shkak të sjelljes së inflacionit. Inflacioni i çmimeve të konsumit për vitin 1999 parashikohet të rritet me 1.4 për qind, ndërkohë që nuk ka shenja të dukshme në

⁴ IMF, World Economic Outlook (Washington D.C.), October 1999.

⁵ Institute of International Finance, Inc., Capital Flows to Emerging Market Economies (Washington D.C.), 25 September 1999.

rritjen e inflacionit të pagave, megjithëse papunësia ka rënë në 4.25 për qind, niveli më i ulët që prej gati tre dekadash. Në përgjigje të zhvillimeve të tregut, për herë të tretë gjatë pesë muajve të fundit, Fed-i ngriti (në muajin nëntor) normat e interesave me 0.25 pikë (me këto nivele normat e interesit u ngritën edhe në muajt qershor dhe gusht).

Tabela 2: Rritja ekonomike, në përqindje kundrejt vitit paraardhës.

	1998	1999
Prodhimi i Përgjithshëm Botëror	2.5	3.0
Vendet e industrializuara	2.2	2.8
SHBA	3.9	3.7
Japonia	-2.8	1.0
Bashkimi Europian	2.7	2.0
Zona e Euro	2.8	2.1
Vendet në zhvillim	3.2	3.5
Afrika	3.4	3.1
Azia	3.7	5.3
Lindja e Mesme dhe Europa	3.2	1.8
Hemisfera Perëndimore	2.2	0.1
Vendet në Tranzicion	-0.2	0.8
Europa Qendrore dhe Lindore	2.2	1.0
Volumi i Tregtisë Botërore	3.6	3.7

(Burimi: IMF, World Economic Outlook, October 1999)

Me rritjen e shënuar gjatë gjysmës së parë të vitit, teknikisht ekonomia japoneze konsiderohet se ka dalë nga recesioni që e mbante të mbërthyer që nga viti 1992. Për të ruajtur rritjen e shënuar gjatë kësaj periudhe, Qeveria Japoneze adaptoi, në muajin shtator, një tjetër paketë fiskale (paketa e 11-të fiskale që nga viti 1992) për nxitjen e investimeve publike. Efektet e paketave fiskale, të fuqizimit të konsumit privat dhe të një kthese të shënuar nga eksportet, pritet të mbështesin rritjen prej 1 për qind të PBB-së për vitin 1999, pas rënies që e ka shoqëruar këtë vend që nga fillimi i viteve '90 të shekullit të kaluar.

Përmirësimi i mjedisit të jashtëm ekonomik, lehtësimi i kushteve monetare nga Banka Qendrore Europiane, forcimi i mëtejshëm i konfidencës së biznesit dhe të konsumit, si dhe zhvlerësimi i euro-s që nga momenti i hyrjes së saj, konsiderohen si faktorët bazë pas të cilëve qëndron optimizmi për një rritje më të lartë nga parashikimi i ekonomisë europiane. Rritja vjetore në zonën e euro-s parashikohet të jetë 2.1 për qind ndërsa niveli i objektivit të inflacionit nën 2 për qind nuk është vënë në rrezik, megjithë presionin e ushtruar nga rritja e çmimit të naftës dhe zhvlerësimet monetare (shih box.3).

Ndërsa për ekonominë në tranzicion parashikohet që rritja ekonomike të shënojë 0.8 për qind, një rritje mjaft më optimiste, që bazohet kryesisht në kapërcimin e

krizës ruse (pas një rënieje prej 4.7 për qind gjatë vitit 1998, për vitin 1999 sipas vlerësimeve zyrtare ruse parashikohet që prodhimi përgjithshëm të rritet 1.5 për qind) dhe përmirësimin e koniukturës botërore të çmimeve të mallrave primare dhe energjitike. Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore parashikohet të përjetojnë një rënie më të madhe të ekonomisë krahasuar me një vit më parë. Ndër më të goditurat janë ekonomitë e Rumanisë (me -4 për qind), FYROM (me -6 për qind), si dhe të Çekisë, Kroacisë dhe Bullgarisë (nga -1 për qind në -1.5 për qind). Sipas vlerësimeve të ndryshme, konflikti në Kosovë dha ndikime negative në perspektivat ekonomike të Europës Juglindore (shih box.2).

Box. 3: Ecuria e monedhës së re europiane – EURO.

Megjithëse ka kaluar vetëm një vit që nga hyrja e monedhës së re europiane, euro, gjë që e bën të vështirë dhënien e një panorame të gjerë të ecurisë së saj⁶, më poshtë po japim disa vëzhgime mbi zhvillimet më të rëndësishme të shënuara gjatë këtij viti.

Zbatimi i politikës monetare mund të thuhet se u realizua pa probleme. Politika e përbashkët monetare garantoj ruajtjen e stabilitetit të çmimeve, duke mbështetur njëkohësisht edhe rigjallërimin e ekonomisë së zonës. Kështu, objektivi i inflacionit sipas përcaktimit nën 2 për qind u arrit, ndërkohë që parashikohet që ekonomia e zonës të rritet me gati 3 për qind në vitin 2000. Suksesi i arritur është e natyrshme të ketë kontribuar dhe në forcimin e kredibilitetit të Eurosistemit në tërësi.

Euro, gjithashtu, u shndërrua në një prej monedhave udhëheqëse në tregjet botërore të investimeve dhe të tregtisë. Ajo qëndron paralelisht me dollarin si monedha më e tregtueshme dhe më likuide në tregjet valutore botërore. Statistikat paraprake flasin se gjatë 9 muajve të vitit 1999, pjesa e letrave me vlerë të borxhit të qeverive, të emëtuara në këtë monedhë, të ketë arritur në 40-45 për qind të emetimeve totale të reja, duke shkuar gati në të njëjtin nivel me pjesën e letrave me vlerë të borxhit të emëtuara në dollarë. Më shumë se 50 vende europiane dhe afrikane kanë lidhur monedhat e tyre me euron (ose shportë monedhash, ku euro përbën monedhën kryesore). Megjithatë, investitorët privatë janë treguar më të matur në emetimin e letrave me vlerë të emëtuara në euro. Gjithashtu, zbatimi i suksesshëm i sistemit të pagesave TARGET, kontribuoi në integrimin e shpejtë të tregut monetar europian.

Ndërkohë, tregjet financiare europiane akoma vazhdojnë të vuajnë nga një shkallë e lartë fragmentarizimi dhe mungese të konkurrencës midis vendeve, volume të ulëta të tregtimit, kosto të larta dhe hezitimi në emetimin e instrumenteve të reja financiare. Me rëndësi të madhe në zhvillimin e tregjeve financiare të zonës së euros paraqitet harmonizimi i legjislationit të vendeve anëtare (iniciativat për të cilën nuk mungojnë); harmonizimi i infrastrukturës teknike të menaxhimit etj.. Për këtë qëllim, shefat e shteteve të vendeve anëtare miratuan, në verën e të vitit të kaluar, një plan veprimi për tregun financiar, i cili konsiderohet si një iniciativë shumë e rëndësishme në kapërcimin e diferencave midis shteteve dhe segmentimit të tregjeve kombëtare.

Box. 4: Pakti i Stabilitetit.

Fundi i konfliktit në Kosovë, i dha jetë intensifikimit të përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar për fuqizimin e proceseve integruese të vendeve ballkanike në nivel rajonal, por dhe një lidhjeje më të fuqishme të rajonit me Bashkimin European dhe, në një kontekst më të gjerë, me ekonominë ndërkombëtare. Bazat e këtij bashkëpunimi, arritja e hartimit të një Pakti Stabiliteti për Europën Juglindore, të finalizuar në takimin e G-7 në Këln dhe të shpallur formalisht në takimin e Sarajevës, paraqesin trasenë në të cilën do të kalojë ky proces.

Struktura kryesore organizative e paktit realizohet në kuadrin e Tryezës Rajonale të Europës Juglindore nën kryesinë e Koordinatorit Special të BE për Paktin e Stabilitetit. Tryeza Rajonale, me përfaqësues nga të gjitha vendet pjesëmarrëse, siguron koordinimin midis tre tryezave të punës: për demokracinë, rindërtimin e ekonomisë dhe problemet e sigurimit. Ky pakt, krijon baza për një qëndrueshmëri politike dhe të sigurisë në

⁶ Përfitimet nga një bashkim monetar janë të një natyre afatgjatë dhe strukturore. Për rrjedhojë, vlerësimi i ecurisë së euro-s bazuar vetëm në vlerën e saj të jashtme nuk do të ishte i plotë.

rajon, të cilat janë parakushte të nevojshme për zhvillimin dhe nxitjen e sipërmarrjes së lirë private, si motorët kryesorë të rritjes ekonomike.

Në kontekstin e këtij pakti, Bashkimi European ka nisur Procesin e Stabilizimit dhe Asocjimit, si një rrugë për integrimin progresiv të këtyre vendeve në strukturat e BE. Instrumenti kryesor i BE për këtë qëllim është Marrëveshja e Stabilitetit dhe Asocjimit, si hap paraprak për anëtarësimin në BE. Është e mundshme që negociatat të fillojnë me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Shqipërinë.

Në këtë kuadër Shqipëria ka mundësi të përfitojë së tepërmi. Pranimi i paktit dhe përpjekjet për vënien në jetë të tij ndihmojnë për një ringjallje të gjithanshme ekonomike, ngritje të infrastrukturës, apo sheshim të problemeve që kanë të bëjnë me ato fenomene, që janë theksuar tashmë shpeshherë si pengesa kryesore për zhvillim të vendit siç janë mungesa e rendit, korrupsioni, mungesa e transparencës së plotë mbi shpenzimet dhe ndihmën e huaj etj. .

2. PRODHIMI I BRENDSHËM BRUTO

Që nga viti 1993, përjashtuar vitin 1997, ekonomia shqiptare, në mënyrë të vazhdueshme, ka njohur përqindje të larta rritjeje (shih grafikun 5). Pas një përmbysjeje totale në vitet e para të tranzicionit, rritja ekonomike e vendit në vitin 1993 regjistroi një nivel lartë në masën 10 për qind. Edhe gjatë viteve në vazhdim ekonomia e ruajti këtë ecuri, duke përshpejtuar ritmet, diçka më shumë në vitet 1995 dhe 1996, për t'u ndalur totalisht nga përmbysja e piramidave. Edhe pse prodhimi në vitin e mbrapshtë 1997 u kontraktua në masën 7 për qind, ky proces i anasjelltë vlerësohet të jetë eliminuar nga nivelet e rritjes të konstatuara në periudhën dyvjeçare 1998 – 1999.

Ecuria e rritjes ekonomike gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, e cila përgjithësisht pranohet se përkon me një përqindje mesatare të lartë rritjeje, është rrjedhojë e strukturës së ekonomisë shqiptare të trashëguar dhe pa dyshim edhe e politikave dhe reformave të ndërmarra gjatë kësaj periudhe.

Më konkretisht mund të evidentohen tre faktorë kontribues. Së pari, tradicionalisht ekonomia e Shqipërisë, në pjesën më të madhe, është dominuar nga bujqësia. Privatizimi shumë i shpejtë i tokës bujqësore ndikoi në rritjen e produktivitetit, gjë që kontribuoi në një rritje të shpejtë të prodhimit bujqësor, i cili mesatarisht gjatë periudhës 1992 – 1995 llogaritet në 12,5 për qind në vit. Së dyti, shkalla shumë e ulët e hapjes së vendit kundrejt botës gjatë sundimit komunist, shërbeu si një lloj mbulese mbrojtëse nga humbjet e tregjeve të eksporteve tradicionale, fenomen i cili u evidentua gjerësisht në ekonominë e tjera në tranzicion. Së treti, krahasuar me vendet e tjera lindore, sidomos me ato fqinje, Shqipëria filloi rrugën e tranzicionit nga një shkallë shumë e ulët zhvillimi dhe me disnivel të lartë në sasinë e të ardhurave.

Në përgjigje të këtij niveli, ndërtimi startoi fuqishëm nga një bazë shumë e ulët, duke reflektuar nevojat e një ekonomie tregu në zhvillim dhe gjendjen distrofike të infrastrukturës në fund të periudhës së ekonomisë së centralizuar. Në mënyrë të ndjeshme reagues transporti dhe sektori i shërbimeve, të cilët gjatë gjithë kësaj periudhe kanë rritur në vazhdimësi peshën e tyre në PBB.

Pas vitit 1995, prodhimi bujqësor duket se ka pësuar një lloj stopimi shkaktuar nga ngadalësimi i reformave strukturore dhe për rrjedhim kontributi i tij në rritjen e PBB-së vlerësohet të jetë zvogëluar në terma mesatarë.

"Lulëzimi, venitja" dhe periudha pas falimentimit të skemave piramidale, pati një ndikim të drejtpërdrejtë mbi strukturën e rritjes ekonomike. Së pari, lulëzimi i skemave gjatë vitit 1996 dhe rritja e dukshme në mirëqënien e popullsisë, në kushtet e një humbjeje të kontrollit fiskal dhe monetar, induktoi një *boom* të paparë në konsumin privat, i cili nga ana e tij kontribuoi në një rritje të prodhimit industrial. Së dyti, perceptimi i piramidave si një burim shumë i lehtë fitimi, vlerësohet të ketë ndikuar në mentalitetin e fermerëve duke i bërë ata indiferentë ndaj profesionit të tyre, gjë që shpjegon ngadalësimin e madh në rritjen e prodhimit bujqësor, deri diku edhe shkatërrim të ekonomisë individuale bujqësore. Së treti, pas kolapsit, rritja e ndërtimit dhe e shërbimeve, dy sektorëve më të prekur nga kriza, reagoi fuqishëm, kryesisht në përgjigje të nevojave për rindërtimin e infrastrukturës dhe të godinave të banimit. Një nga burimet kryesore financiare, të përdorura në ndërtimet e reja, llogaritet të jenë dërgesat nga emigrantët.

Ndryshimet strukturore të ndodhura në vitin 1996 në modelin e rritjes, evidentohen dhe në anën e kërkesës (shih grafikun 6). Ndërkohë që gjatë periudhës 1993 – 1995 rritja e kërkesës agregate ishte poshtë rritjes së PBB-së, krejt ndryshe në periudhën e parakrizës,

në vitin 1996 modeli i rritjes pësoi ndryshim në mënyrë të anasjelltë, i cili kryesisht origjinohe nga *boom*-i i madh që pësoi konsumi. Rritja më e madhe e kërkesës krahasimisht me atë të prodhimit, është evidentuar edhe gjatë dy viteve të fundit. Ndërkohë që në vitin 1998 kërkesa e brendshme u rrit natyrshëm, pa praninë e faktorëve rastësorë dhe të jashtëzakonshëm, në vitin 1999, rritja e kërkesës së brendshme është thjesht derivat i efektit "Kosova". Të dhënat për konsumin dhe investimet⁷, argumentojnë më mirë konkluzionin e mësipërm. Ndërsa në vitet e para të tranzicionit ato ishin në rënie, ritmika e tyre ka ndryshuar në dy vitet e fundit duke reflektuar një zhvendosje në rritje, të barabartë pak a shumë me ritmin e rritjes së PBB-së. Pavarësisht nga kjo, duhet theksuar se niveli i investimeve, krahasuar me nevojat e mëdha të vendit në infrastrukturë dhe në pajisje, akoma konsiderohet i ulët, ndërkohë që eksportet vazhdojnë të jenë në nivele modeste dhe me luhatshmëri të madhe.

Megjithë konfliktin në rajonin e Ballkanit, ekonomia shqiptare arriti të shmangë pasojat negative dhe për më tepër në aspektin moral fitoi dhe diçka të humbur nga ngjarjet e vitit 1997. Është fakt se sektorët që u prekën më tepër nga kriza kanë peshë më të ulët, ndërkohë që si pasojë e efektit të zëvendësimit të dëmit të pësuar në disa degë me gjallërimin e disa të tjerave (po si pasojë e krizës) u regjistruan zhvillime të rëndësishme në sektorin e shërbimeve, në ndërtim etj..

Prodhimi i brendshëm bruto gjatë vitit 1999 është rritur në masën 8 për qind. Siç vihet re edhe në tabelën 3, degët bazë që kanë kontribuar në këtë rritje mbeten bujqësia, ndërtimi dhe shërbimet.

Prodhimi industrial gjatë vitit 1999, njohu një rritje në masën 6,4 për qind, duke zënë rreth 12 për qind të totalit të prodhimit të përgjithshëm. Duke ju referuar të dhënave të pakta të disponueshme, do të evidentonim se rritja ekonomike e këtij sektori, në pjesën më të madhe, është atribut i prodhimit industrial të siguruar nga sektori privat.

Nga ana tjetër, të dhënat zyrtare, evidentojnë një gjendje pak a shumë stacionare të prodhimit industrial në sektorin shtetëror të ekonomisë. Edhe prodhimi mall i shitur, i realizuar deri në fund të muajit dhjetor 1999, i krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar shënon një rënie prej rreth 13.4 për qind. Nga një analizë e shkurtër e sektorëve industrialë vërehet se dobësitë më të mëdha mbeten në sektorin minerar, veçanërisht në industrinë e bakrit dhe kromit, ku u arrit vetëm gjysma e aktivitetit ekonomik të realizuar nga ky sektor gjatë vitit të kaluar. Me përjashtim të sektorit të energjisë elektrike, i cili vazhdon të ruajë dinamizmin e prodhimit, në nivele të dobëta vazhdojnë të qëndrojnë edhe prodhimi i çimentos, materialeve të tjera të ndërtimit, industria metalurgjike etj.. Duket se proceset e privatizimit dhe të ristrukturimit të disa prej këtyre sektorëve (siç është rasti i Kombinatit Metalurgjik) akoma nuk kanë filluar të japin efektet e tyre.

Prodhimi bujqësor ruajti të njëjtin hap rritjeje ashtu si dhe një vit më parë, në nivelin 5 për qind. Bujqësia mund të thuhet se mbeti e paprekur nga zhvillimet e ndodhura dhe vazhdon të ruajë ritmet e saj konstante të rritjes duke siguruar dhe bazën kryesore në rritjen e prodhimit të përgjithshëm. Megjithatë, kontributi i saj në

⁷ Të dhënat për konsumin dhe investimet janë thjesht vlerësime, prandaj duhen marrë me rezerva.

totalin e prodhimit, për të dytin vit rradhazi, ka ardhur në rënie, duke u ndalur në nivelin 53 për qind në fund të vitit 1999 nga 56 për qind në fund të vitit 1997.

Kuptohet se rritja e produktivitetit në fillimet e periudhës së tranzicionit tashmë nuk është e mjaftueshme. Rritja e kontributit të kësaj dege parësore të prodhimit, domosdoshmërisht kërkon shtim të mëtejshëm të produktivitetit, ku rol kryesor do të luajë mekanizimi i mëtejshëm i saj. Aktualisht, megjithë procesin e hershëm të privatizimit, forma e pronësisë mbi tokën ka mbetur e pandryshuar ashtu si në momentin e privatizimit. Zotërimet mbi tokën në përmasa të vogla (llogaritet që mesatarisht të jetë diçka më pak se 1 hektar për një zotërues) vlerësohet të jenë pengesa serioze në shpërthimin e ekonomisë në shkallë të gjerë. Përpjekjet për kooperimin e mjeteve prodhuese, të tokës, të mekanikës dhe të krahëve të punës, janë të pranishme, por gjithësesi ato mbeten sporadike.

Tabela 3. Prodhimi i Brendshëm Bruto.

	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Rritja reale e PBB	-10.0	-28.0	-7.2	9.6	8.3	13.3	9.1	-7.0	8.0	8.0
Industria	-14.2	-42.0	-51.2	-10.0	-2.0	6.0	13.6	-5.6	4.1	6.4
Bujqësia	-5.4	-17.4	18.5	10.4	8.3	13.2	3.0	1.0	5.0	5.0
Ndërtimi	-12.0	-30.0	7.0	30.0	15.0	21.2	18.4	-6.3	21.0	15.0
Transporti	-10.0	-30.0	-15.0	13.0	18.0	18.7	-0.9	-20.5	20.0	15.0
Shërbimet	-8.0	-14.0	9.0	16.0	11.0	13.5	20.1	-25.0	10.0	12.0
Kontributi në PBB			100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Industria			16.9	13.9	12.5	11.7	12.2	12.4	12.0	11.8
Bujqësia			54.2	54.6	54.6	54.6	51.5	56.0	54.4	52.9
Ndërtimi			7.6	9.1	9.6	10.3	11.2	11.2	12.6	13.4
Transporti			3.0	3.1	3.4	3.5	3.2	2.7	3.0	3.2
Shërbimet			18.3	19.4	19.8	19.9	21.9	17.7	18.0	18.7

Burimi: Ministria Financave dhe vlerësime të FMN-së.

Ashtu si dhe në vitin e kaluar, edhe gjatë vitit 1999, vlerësohet se **dega e ndërtimit** dhe **ajo e transportit** kanë pasur rritjen më të madhe, secila me 15 për qind. Por, ndryshe nga ritmi i rritjes, pesha që ato zënë në totalin e prodhimit ndryshon ndjeshëm, nga 13,4 për qind për degën e ndërtimit në 3.2 për qind për atë të transportit. Përveç faktorëve tradicionalë (konsolidimit të sektorit privat të angazhuar në biznesin e ndërtimit), dega e ndërtimit vazhdon të ruajë dinamikën e rritjes dhe, për rrjedhojë, të një numri të madh projektesh publike të financuara nga Komuniteti Ndërkombëtar, NATO dhe OJQ të ndryshme.

Pas goditjes që pësoi në vitin 1997, dega e shërbimeve duket se ka filluar të rigjallërohet me shpejtësi, pasi në vitin 1999 regjistroi një nivel rritjeje 12 për qind, në vijim të një ecurie po pozitive në vitin 1998 (10 për qind rritje). Pesha ndaj totalit të përgjithshëm, megjithëse është akoma poshtë nivelit të saj rekord në vitin 1996, ka një tendencë në rritje dhe mendohet që rëndësia e këtij sektori do të vijë duke u shtuar në të ardhmen.

3. KURSIMET DHE INVESTIMET

Përqindja e kursimeve⁸ kombëtare të brendshme gjatë vitit 1999, ndryshe nga viti i kaluar, rezultoi në masën 7.5 për qind të PBB-së. Në vetvete, kjo shifër pasqyron një ecuri në kahje të kundërt të nivelit të tyre në të dy sektorët përkatës. Më konkretisht, është evidentuar një rritje e kursimeve në sektorin privat të ekonomisë dhe një deficit më i thelluar i kursimeve të sektorit publik. Siç shihet dhe nga grafiku 10, kursimet e sektorit privat janë mbi nivelin e regjistruar në vitin e kaluar, fenomen i cili njeh të njëjtat zhvillime në serinë që i takon kursimeve publike, por që në ndryshim nga e para mban shenjë negative.

Edhe gjatë vitit 1999, niveli i kursimeve në sektorin publik regjistroi një nivel negativ në masën -8,9 për qind të PBB-së, 0,8 pikë përqindjeje më të lartë se niveli i faktuar në vitin 1998. Ky nivel negativ në masën më të madhe shpjegohet nga efekti pështjellues i krizës së Kosovës në mbledhjen e të ardhurave tatimore, ndërkohë që mosrealizimet në grupin e shpenzimeve prekën kryesisht grupin e shpenzimeve kapitale.

Kursimet në sektorin privat⁹ llogariten të jenë rritur me 0,5 pikë përqindjeje të PBB-së. Megjithëse shkaqet e rritjes nuk janë plotësisht të qarta, vlerësohet se prapa kësaj rritjeje qëndrojnë individët, ndërkohë që për kontributin e sektorit të biznesit nuk mund të thuhet asgjë konkrete. Edhe gjatë vitit të kaluar, në mungesë të tregjeve, të ardhurat e shqiptarëve nuk gjetën ndonjë rrugë më fitimprurëse përveçse asaj të vendosjes në depozita bankare. Sipas të dhënave të fundvitit 1999, gjendja e depozitave me afat të individëve në sistemin bankar, në shumë absolute, arriti në 158,4 miliardë lekë rreth 27,6 miliardë lekë më shumë se fundi i vitit të kaluar. E shprehur në terma relativë, gjendja e depozitave me afat përbën rreth 31,6 për qind të PBB-së, nga 29,7 për qind që ishte një vit më parë.

Si pasojë e mosfunksionimit të mekanizmit të transmisionit në procesin e ndërmjetësimit financiar, sasia e madhe potenciale në formën e kursimeve të individëve, nuk gjen hapësirat më të domosdoshme për të investuar pjesë të saj në prodhim, shërbime etj.. Sipas disa vrojtimeve të pavarura theksohet se pjesa e vendosur në formë depozitash në sistemin bankar është vetëm një fraksion i totalit. Vërtetësinë e kësaj gjetjeje e mbështet fakti që pesha e ekonomisë joformale vlerësohet të jetë mbi 50 për qind e aktivitetit ekonomik të vendit¹⁰.

⁸ Bilanci që rezulton nga diferenca midis nivelit të të ardhurave me shpenzimet korente.

⁹ Në mungesë të statistikave të plota të llogarive kombëtare, shifrat për kursimet dhe investimet janë thjesht vlerësime, ku niveli i atyre private është më i diskutueshmi. Për më tepër, mungon vlerësimi i tyre sipas klasifikimit ndërkombëtar të SNA dhe për rrjedhim kemi një detajim të tyre vetëm në dy nivele: kursime të sektorit publik dhe kursime të sektorit privat. Në nëndarjen e dytë është përfshirë çdo njësi e kursimeve që nuk është produkt i llogarive të buxhetit. Siç shihet, kursimet e individëve, të biznesit dhe të sektorit financiar janë përfshirë të gjitha në nëndarjen kursime private.

¹⁰ Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike, 1999 "Sektori informal në Shqipëri: raport empirik", "Ekonomia dhe Tranzicioni" nr. 1 (19); Dr. Nexhmedin Dumani, 1999 "Sektori informal: rrugët e minimizimit të tij", "Ekonomia dhe Tranzicioni", nr .1 (19).

Për arsye të mëtejshme sipër dhe për vetë faktin se shpenzimet për investime të buxhetit (të shprehura si përqindje ndaj PBB-së) pësuan një ulje të lehtë, niveli i përgjithëm i investimeve bruto u rrit shumë pak vetëm 0,7 pikë përqindjeje. Pavarësisht nga fakti nëse u rrit dhe sa u rrit rëndësi ka të nënvizohet se niveli i tyre si në shumë absolute ashtu dhe në përqindje ndaj PBB-së vazhdon të jetë i ulët.

Box. 5: Pse Shqipërisë i mungojnë investimet? – vështrim problematik.

I. Investimet publike:

Në ushtrimin e rolit të investitorit, drejtimet e akordimit të burimeve financiare të qeverisë janë përcaktuar në dokumentin e Programit të Investimeve Publike, që ka filluar të hartohet për herë të parë në vitin 1993 dhe që është revizionuar çdo vit, në përputhje me ndryshimet e ndodhura apo nga presione të ndryshme të tregut. **Duke parë shkurtimisht historikun e realizimit të programeve të investimeve publike, tipari i parë dallues është mosrealizimi i tij në mënyrë permanente:** vazhdimisht ka ekzistuar një diferencë midis angazhimeve të fondeve dhe realizimeve të tyre (qoftë nga financimet e huaja, qoftë dhe nga vetë fondet e brendshme buxhetore). Pse nuk realizohen investimet e programuara? Mund të thuhet se zgjidhja e këtij problemi lidhet gati tërësisht me forcimin e kapaciteteve institucionale, të aktiviteteve të tyre programuese, negociuese dhe monitoruese. Mospërgatitja e projekteve, moshthitja e parave të angazhuara nga komuniteti ndërkombëtar për investimet në projektet publike (por dhe në financimet në mbështetjen e zhvillimit të sektorit privat), zvarritjet në lëvrimin e fondeve dhe në mosrealizimin e investimeve nga ana e ministrive të linjës, shprehin paaftësi të organeve të administratës dhe mungesë të aftësive dhe kompetencave të dallueshme profesionale. Shteti si investitor, jo vetëm rregullon dhe mirëmban infrastrukturën sociale të vendit, por edhe përgatit infrastrukturën e nevojshme për investimet private. Pra, ai kujdeset për zhvillimin e shërbimeve publike, cilësia e të cilave është një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e sektorit privat. Partneriteti i shtetit me sektorin privat në investimet publike nuk ka njohur ndonjë zhvillim të ri. Megjithatë që në fillim të vitit 1996 është adaptuar nga Kuvendi një ligj për koncesionet, deri tani kjo formë operimi nuk është zhvilluar, megjithë interesat e shfaqura nga investitorë të caktuar për të operuar në fusha me rëndësi kritike. Kohët e fundit duket sikur po lëviz diçka (me koncesionet në minierat e bakrit, të kromit dhe të ferrokromit), përsëri përshtypja është se deri tani kjo ka mbetur vetëm në nivelin e propagandës. Për më tepër, procesi i dhënies së koncesioneve duhet të shoqërohet me më shumë informacion për publikun lidhur me kostot dhe përfitimet e vendit nga një gjë e tillë.

II. Investimet private:

Shteti si rregullator, duhet të përcaktojë qartë rregullat e lojës për gjithë lojtarët e tregut, ku arbitër për respektimin e tyre janë gjykatat. A është përmbushur ky funksion? **Ekziston një bindje tek të gjithë operatorët e biznesit privat se rregullat e lojës janë jo qartë të përcaktuara:** se ligjet janë me mjaft dykuptimësi duke krijuar hapësira për interpretime subjektive; se ekziston një konkurrencë e pandershme në treg, e cila dëmton ndjeshëm sipërmarrjet serioze dhe dekurajon zgjerimin e investimeve të tyre; se kriteret e dhënies së lejeve e licencave për kryerjen e një aktiviteti nuk janë gjerësisht të zhvilluara dhe qartësisht të përcaktuara; se procedurat e prokurimeve brenda institucioneve të administratës shtetërore janë të korruptuara dhe kjo e fundit shihet si endemike; se nuk ekziston një treg i mirëfilltë financiar i mbushur me të gjithë operatorët e tij, se infrastruktura është e pazhvilluar; se ka mjaft konfuzion në çështjet e pronësisë etj.. Është e natyrshme se përmbushja e funksioneve të tilla nuk është një akt i njehershëm dhe as nuk përfundon me plotësimin e tyre. Ai është një proces permanent dhe që zhvillohet e përsoset gjithnjë në rritje. Por, ngadalësia e përmbushjes së detyrimeve të tilla, paraqet pengesa serioze për zhvillimin e biznesit. Disa iniciativa qeveritare lidhur me rritjen e transparencës së organeve të administratës shtetërore ndaj publikut dhe subjekteve private si dhe lehtësimin e kushteve të operimit të sektorit privat, janë mbyllur që në lindje, pa mundur të sjellin asnjë rezultat konkret.

Të gjitha këto veprime, duke mbetur thjesht në kuadrin e propagandës, krijojnë dhe ndjenjën e mungesës së seriozitetit para komunitetit të investitorëve dhe tkurrin aktivitetin investues, në pritje të ndodhjes së ndryshimeve pozitive.

Nëse ndodh një mosmarrëveshje qoftë midis subjekteve private apo një subjekti privat dhe shtetit, roli i gjykatave bëhet esencial në dhënien e së drejtës subjektit që i takon. Ekzistojnë mjaft të dhëna anekdotë se e drejta nuk ndahet sipas ligjit, por sipas faktorëve të tjerë, duke e renditur institucionin e së drejtës në të njëjtin rend korupsioni me organet doganore dhe tatimore. **Shteti, si mbështetës i sektorit privat në formën më të drejtpërdrejtë, realizohet nëpërmjet mbështetjes me financime direkte për të.** Ndihma e drejtpërdrejtë financiare është një instrument që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara. Është e kuptueshme se kushtet e financave të shtetit nuk mund të përballojnë një ndihmë të tillë, por fatkeqësisht, strukturat e shtetit kanë qenë të paafta të thithin dhe mbështetjen financiare të ofruar nga donatorët e huaj për mbështetjen e sipërmarrjes private të vendit, ku nga rreth 170 milionë dollarë të angazhuar janë lëvruar vetëm rreth 85 milionë dollarë

(projektstrategjia për SME, MBET, 1999) dhe kjo është realizuar kryesisht në aspektet e asistencës teknike dhe jo në mbështetjen e projekteve të zhvillimit.

Mbështetja në *formën e tërthortë* konsiston në çlirimin e subjekteve private nga detyrimet (ose një pjesë e detyrimeve) tatimore e doganore. Justifikimi i një mbështetjeje të tillë qëndron në argumentin se këto instrumente reduktojnë koston e investimit, pra dhe të kapitalit, dhe rrisin fitimprurjen e projekteve investuese duke nxitur kështu procesin investues. Sipas BERZH (1999), nga 26 ekonomitë në tranzicion, 12 prej tyre ofrojnë mbështetje të tillë (pjesa dërrmuese e vendeve nuk japin raportim mbi sistemin mbështetës për investime. Në fakt, vetëm 3 vende: Shqipëria, Estonia dhe Moldavia shprehin në mënyrë eksplicite mosdhënie favoresh të tilla). Një regjim i tillë preferencial u zbatua dhe nga vendi ynë, duke filluar që nga viti 1993, por nga mesi i vitit 1995 janë eliminuar gradualisht këto forma të mbështetjes. Rritja progresive e niveleve tatimore të shënuara në vitet e fundit ka ndikuar në një rritje të koston së investimit. Duke i shtuar kësaj edhe koston e lartë të kapitalit (normat e larta të interesave bankare), aktiviteti investues është frenuar (të paktën potencialisht) dhe/ose tregu është deformuar. Nga ana tjetër, reduktimi permanent i normave të interesit për depozitat i ndërmarrë nga Banka e Shqipërisë, nuk është reflektuar me të njëjtin intensitet dhe shkallë në reduktimin e normave të interesit për kreditim. **Kontrabanda, evazioni si dhe praktikat korruptive në organet doganore e tatimore deformojnë konkurrencën e tregut dhe i vendosin sipërmarrësit në pozita diskriminuese.** Niveli i lartë i korrupsionit në institucionet shtetërore është një taksë e posaçme jo e neglizhueshme. Sipas vlerësimeve të BERZH (1999), firmat në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore paguajnë një taksë korrupsioni, që luhet nga 2 për qind e të ardhurave vjetore të firmave në Kroaci, në 8 për qind në Gjeorgji. Ka mjaft arsye të besohet se ky nivel takse për Shqipërinë është më i lartë, duke përbërë një pengesë serioze në zhvillimin e sipërmarrjes private.

Ky kuadër prezantues, i referohet gjithë investimeve private, përfshirë dhe investitorët e huaj. Por, **mungesa e investitorëve të huaj lidhet dhe me veprimin e faktorëve të tjerë, ku ndër më të rëndësishmit përmendim ecurinë e procesit të privatizimit.** Në gjithë ecurinë e tij, privatizimi nuk është realizuar në bazë të një kalendari kohor të publikuar që më parë, i cili, së bashku me procedurat përkatëse, të botohej që të ishte i disponueshëm nga publiku, veçanërisht ai i huaj. Për më tepër, edhe privatizimet e shpallura, në shumicën e rasteve janë shtyrë vazhdimisht për afate të mëvonshme, duke krijuar kështu "bezdisjen" e investitorëve të interesuar dhe më në fund dhe largimin e tyre. Megjithëse dokumenti i strategjisë së privatizimit, i miratuar nga Kuvendi, parashikon afate kohore strikte, respektimi tyre lë për të dëshiruar. Dhe akoma më tej, duke shkelur ligjin shqiptar të investimeve të huaja dhe konventat ndërkombëtare ku aderon vendi ynë, legjislacioni i tatimit mbi të ardhurat, mban ndaj tyre një qëndrim diskriminues: tatimi mbi interesat bankare, dividendët dhe fitimet kapitale për jorezidentët, 15 për qind, ndërsa për rezidentët, 10 për qind.

III. Investimet portofol:

Megjithëse është e tepërt të flasim për këtë formë investimi pasi nuk ekziston një treg kapitalesh i organizuar, i pajisur me aktorët dhe instrumentet e njohura të një tregu të tillë, duam të evidentojmë se edhe në tregun e bonove të thesarit, i vetmi instrument ku mund të investohen kursimet e brendshme dhe të jashtme, kjo formë investimi është akoma e pazhvilluar. Pse? Mungesa e ndërmjetësve financiarë në treg, i heq mundësinë publikut të marrë pjesë në të. Nxitja e privatëve vendas për të marrë pjesë në këtë treg ka munguar thuajse tërësisht. Nuk ekziston asnjë material njohës dhe shpjegues për publikun se si mund të investohet në këtë treg, procedurat, avantazhet, garancitë etj..

Duke qenë se operacione të tilla akoma konsiderohen nga shumica e publikut si "të sofistikuar", joshja për të hyrë në të vazhdon të ekzistojë në një formë latente, të fjetur. Është detyrë e Bankës së Shqipërisë dhe e qeverisë, si organizatore dhe zhvilluese e këtij tregu të nxisin pjesëmarrjen e publikut në këto veprimtari dhe ato janë angazhuar në një proces të tillë.

Tërheqja e ndërmjetësve të huaj mund të konsiderohet si e parakohshme, sa kohë që letrat me vlerë të qeverisë emetohen vetëm në monedhë kombëtare dhe nuk ka ndonjë projekt për emetimin e letrave me vlerë me maturitet afatgjatë në monedhë europiane apo dollarë. Zhvillimi i këtij segmenti lidhet dhe me zhvillimin e bursës dhe perspektivat e përfshirjes në të të pjesëve të aksioneve të "blue chips"¹¹-ve (si AMC, Telekom etj.). Krijimi i ndërmjetësve financiarë akoma nuk gjen rregullimin e duhur ligjor. Dalja e ligjit përbën hapin e parë, i cili duhet të pasohet nga plotësimet nënligjore dhe aktivitetet publicitare në nxitjen e mundësive të reja.

¹¹ Term që përdoret për të emërtuar kompani të mirënjohura.

4. PUNËSIMI DHE TË ARDHURAT

Në gusht të vitit 1999, përqindja e papunësisë në shumicën e vendeve në tranzicion lëkundej nga rreth 9 për qind në 19 për qind. Përgjatë gjithë vitit, niveli i papunësisë në shumicën e këtyre vendeve u rrit mesatarisht me 2 – 3 për qind, duke pasqyruar situatën e vështirë ekonomike si dhe krizat në rajon dhe proceset e intensifikimit të ristrukturimit në këto vende. Nga ky ndikim nuk shpëtoi as vendi ynë, që mbarti mbi vete një pjesë të rëndësishme të kësaj krize.

Megjithë arritjet në stabilizimin e përgjithshëm makroekonomik, të rejtat në tregun e punës gjatë vitit 1999, ishin të pakta e në mjaft raste, krahasuar me objektivat e parashikuara, pati mangësi dhe mosrealizime. Ende mjaft ide të politikave aktive në tregun e punës dhe të të ardhurave nuk janë vënë në zbatim, duke përfshirë edhe mbrojtjen e shtresave më të varfëra të popullsisë.

Përqindja e papunësisë, përgjatë gjithë vitit 1999, mbeti e pandryshuar në nivelin 18 për qind. Ky nivel përbën kuotën më të lartë të regjistruar pas vitit 1995 dhe për më tepër vazhdon të rritet për të tretin vit rradhazi. Krahasuar me nivelin mesatar të shifrës së papunësisë në vendet e Europës Lindore (12,4 për qind), ky nivel papunësie është rreth 45 për qind më lart.

Duhet theksuar se gjatë gjithë dekadës së fundit, zbutja e nivelit të papunësisë mbeti në qendër të prioritetëve për çdo qeveri europianoperendimore. E përmendëm këtë fakt për të nënvizuar anagazhimet serioze që Qeveria Shqiptare duhet të marrë mbi vete, për gjetjen e mundësive dhe rrugëve konkrete për të zbutur këtë nivel papunësie.

4.1 Tregu i punës.

Tregu i punës vlerësohet të ketë pësuar ndryshime të parëndësishme gjatë vitit 1999. Megjithëse për dy vjet rresht vazhdon një periudhë ringjalljeje në prodhim¹², situata në tregun e punës mund të thuhet se vazhdon të përjetojë rënie të mëtejshme. Pa harruar faktorë objektivë të tillë si ngjarjet e vitit 1997, shtatorit 1998, krizës së Kosovës dhe pasojat që ajo induktoi në përgjithësi në ekonomi, ka vend të thuhet se përpjekjet e bëra kanë rezultuar të paefektshme dhe, për më tepër, kanë ngelur vetëm në kuadrin e deklaratave. Të gjitha projektet e adaptuara gjatë periudhës 1997 – 1999, ku fillimisht u propagadua opsioni i “punëve publike” nuk kanë dhënë asnjë efekt dhe për rrjedhim zhbalencimi ekzistues midis ofertës dhe kërkesës së këtij tregu u thellua më tej gjatë vitit 1999. Megjithatë, ajo që mund të konsiderohet më alarmante lidhet me faktin se niveli i lartë i papunësisë duket se do të ruhet edhe në të ardhmen e afërt. Eçja në reformat strukturore që kanë të bëjnë me administratën, privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore, sidomos ato të rëndësishme së veçantë (KESH, TELEKOM, AMC, bankave etj.), deficitet e krijuara ndër vite në realizimin e investimeve etj., në kushtet kur ende nuk po duken veprime konkrete për hapjen e vendeve të reja të punës, të bindin se zbutja e këtij problemi social është ende larg.

¹² Akoma nuk është arritur kapaciteti prodhues i vendit në vitin 1989, vit i cili merret si bazë krahasimi. Kështu, mund të shpjegohet dhe fakti pse rritja ekonomike nuk gjeneron vende të reja pune. Nga ana tjetër edhe shkalla e produktivitetit aktualisht është më e lartë gjë që ndikon në një thithje më të ulët të fuqisë punëtore.

Nga ana tjetër, megjithë vlerësimet për një gjallërim të vazhdueshëm, sektori privat, ndoshta për mungesë të dhënash apo për shkaqe të pashpjegueshme, të paktën sipas të dhënave zyrtare, nuk po kontribuon në thithjen e numrit të madh të të papunëve. Tregues të tillë si mbizotërimi absolut i ndërmarrjeve me një numër nën 10 të punësuarish (vetëm rreth 0.2 për qind e ndërmarrjeve private kanë më shumë se 100 punonjës) në njëfarë mënyre tregon se akoma sektori privat nuk mund të quhet i konsoliduar, ndërkohë që dihet se puna "e zezë" është përhapur gjerësisht.

Zhvillimet e vitit 1999 në punësim pasqyrojnë edhe ndikimin e faktorëve që origjinojnë nga ekonomia e centralizuar si dhe nga vitet e para të tranzicionit. Nga e kaluara trashëguam një strukturë punësimi me përqendrime të mëdha të punonjësve në një numër të vogël ndërmarrjesh tejet të mëdha, por joeficiente. Forca e punës ishte përqendruar kryesisht në industri të tilla si ajo minerare, metalurgjike, kimike, tekstile etj.. Kaq i madh ishte përqendrimi në këto ndërmarrje sa u krijuan dhe qytete të reja ose u shtuan së tepërmi disa ekzistuese.

Pjesa dërrmuese e këtyre ndërmarrjeve, të amortizuara prej vitesh, në vitet e para të tranzicionit ose u mbyllën krejtësisht ose degjeneruan në mënyrë graduale drejt një shkatërrimi total. Pasoja direkte ishte shtimi i menjëhershëm i papunësisë, sidomos në zonat urbane dhe, për fat të keq, shumë qytete ku punësimi ishte zgjidhur nëpërmjet një ndërmarrjeje të vetme u shndërruan në qytete të papunësh. Më konkretisht, më shumë se 50 për qind e forcës së punës në industri u shkurtua gjatë viteve 1993-1994 dhe prirja e zvogëlimit të saj vazhdoi gjatë viteve 1995-1996.

Vitet që pasuan asnjëherë nuk mundën të rikuperonin në shkallë të madhe nivelin e papunësisë. Lindja e bizneseve të reja u përqendrua kryesisht në shërbime, gjë që solli krijimin e ndërmarrjeve të vogla me numër të pakët të punësuarish. Një numër i madh i prej tyre nuk mundi t'i rezistojë falimentimit të skemave piramidale, si rezultat i rënies së prodhimit, uljes së kërkesës, vështirësive në gjetjen e tregjeve të huaja etj., duke çuar edhe një herë në rritjen e numrit të të papunëve.

Edhe politikat restriktive të aplikuara, ku kryesisht dominojnë përpjekjet për një inflacion në një nivel të ulët si dhe mosrealizimet pothuajse të përvitshme nga ana e buxhetit të shtetit në zërin shpenzime kapitale, mund të kenë ndikuar në terma afatshkurtër në rritjen e papunësisë. Megjithatë, përshtatja e ekonomisë me një normë të ulët inflacioni, por të përshtatshme, në një kuadër më afatgjatë nuk përbën një faktor frenues për uljen e papunësisë.

Me rëndësi është dhe fakti që të gjitha të dhënat e tregut të punës (përfshirë numrin e të punësuarve në administratën shtetërore, arsim dhe shëndetësi) janë vlerësime që mbartin shmangie nga realiteti. Numri i të punësuarve në bujqësi, në biznesin privat, metodologjia e përdorur për llogaritjen e numrit të të papunëve etj., kërkojnë domosdoshmërisht rishikimin e vlerësimeve dhe të metodologjisë së përdorur, në mënyrë që ato të jenë sa më afër realitetit.

Box. 6: Emigracioni gjatë viteve '90.¹³

Emigrimi masiv.

Nëntë vjet pas fillimit të procesit të emigrimit (1991), rreth 450.000 vetë ose rreth 14 për qind e popullsisë së vitit 1997, kryesisht të moshës deri 30 vjeç, kanë emigruar. Valët e emigrimit masiv kanë ndjekur, si rregull, zhvillimin politik, ekonomik e social të vendit.

Emigrimi masiv në Shqipëri ka prekur një pjesë të rëndësishme të popullsisë. Në vitin 1995 ai përfaqëson 26 për qind të popullsisë në moshë pune të vendit, 35 për qind të fuqisë punëtore dhe 43 për qind të popullsisë së punësuar. Rreth 22 për qind të familjeve shqiptare kishin nga një, dy e më shumë anëtarë të tyre në emigracion jashtë vendit. Ky fakt ka ushtruar ndikim të rëndësishëm në jetën ekonomike e sociale të vendit. Ai ka ndihmuar në mënyrë të dukshme për të zbutur pasojat e rënies së prodhimit industrial dhe të uljes së pagës reale. Ai ka ndihmuar, gjithashtu, që të ruhet niveli i konsumit të familjeve shqiptare, që të nxitet kërkesa për mallra konsumi të importit, si dhe të nxiten disa lloje investimesh të popullsisë në qytet e në fshat, siç janë investimet në ndërtim, shtëpi banimi, për blerje autoveturash ose material bujqësor etj..

Emigrimi masiv ka përfshirë kryesisht popullsinë e gjinisë mashkullore, që përfaqëson 73 për qind të numrit të përgjithshëm të emigrantëve. Brenda këtij grupi, 34 për qind janë me moshë deri në 30 vjeç dhe moshë mesatare e emigrantëve është 28,8 vjeç. Rreth 66 për qind e emigrantëve janë me prejardhje qytetare. Të emigruarit janë në përgjithësi beqarë, megjithëse 31 për qind e tyre kanë ikur me një ose më shumë anëtarë të familjes. Destinacioni i këtyre rrjedhave të emigracionit është përcaktuar në mënyrë të dukshme nga afërsia gjeografike e vendeve të pritjes, si dhe nga lidhjet ekonomike, historike dhe kulturore. Kështu shpjegohet që 250.000 veta kanë emigruar në Greqi, ku punojnë kryesisht në bujqësi, ndërtim, tregti dhe në veprimtari të tjera shtëpiake dhe rreth 150.000 veta kanë emigruar në Itali ku, përveç bujqësisë dhe ndërtimit, synojnë të punësohen edhe në shërbimet e turizmit dhe në industri. Në vendet e tjera të Europës Perëndimore, në SHBA dhe në Kanada kanë emigruar rreth 50.000 veta.

Për Shqipërinë emigrimi masiv ka ndihmuar të lehtësohet mjaft trysnia mbi popullsinë aktive, duke pakësuar kështu edhe numrin e të papunëve brenda vendit, sidomos në rradhët e moshave të reja dhe me më pak përvojë pune të kualifikuar. Krahas me këtë, dërgesat në valutë të emigrantëve kanë ndihmuar për të zbutur koston sociale që shkaktuan reformat e thella ekonomike brenda vendit.

Vala e fundit e emigrimit masiv të shqiptarëve u shënua në muajt e parë të vitit 1997. Kjo valë u përqendrua vetëm në dy vendet fqinje, në Itali rreth 15.000 veta dhe në Greqi jo më pak se 10.000 veta. Këtë rradhë, shkaku kryesor i emigrimit të shqiptarëve nga vendi ishin trazirat, që u shkaktuan nga humbja e parave të një pjese jo të vogël të popullsisë në institucionet joformale financiare.

Tipare të përgjithëshme të emigrimit të intelektualëve.

Emigrimi i elitës intelektuale ka përfshirë kryesisht moshat e reja (rreth 51 për qind e numrit të përgjithshëm janë të moshës nën 40 vjeç) të gjinisë mashkullore (67,15 për qind të numrit të përgjithshëm), më pak beqarë (vetëm 13,2 për qind të numrit të përgjithshëm) dhe shumica kanë emigruar me familje (66,5 për qind e numrit të përgjithshëm). Dy tiparet e fundit e dallojnë atë nga emigrimi masiv. Kjo tregon se në rastin e emigrimit të elitës intelektuale kemi të bëjmë me lëvizje të menduara mirë dhe që mund të quhen si emigrim i qëndrueshëm me pikësynimin për t'u ngulitur dhe për t'u integruar në vendin pritës.

Një tipar tjetër dallues i emigrimit të elitës intelektuale është se ky ka filluar pak më vonë se emigrimi masiv. Ai përputhet në kohë me hapjen e kufijve shtetërorë dhe sidomos me zbatimin e reformave ekonomike liberale rrënjësore, të cilat shkaktuan dhimbje në shtresa të gjera të popullsisë. Këto reforma, siç dihet, çuan në një rënie të madhe të pagës reale dhe në shkurtimin masiv të vendeve të punës në institucionet shkencore të vendit. Dhe janë pikërisht vitet 1991, 1992 e 1993 që shënojnë edhe numrin më të madh të intelektualëve të emigruar.

Në rradhën e parë të vendeve pritëse qëndrojnë SHBA, ku janë vendosur rreth 23 për qind e emigrantëve dhe Greqia e Italia, ku janë vendosur përkatësisht 19 për qind dhe 18 për qind e tyre. Por, edhe vendet e tjera të

¹³ Burimi: "Emigrimi i elitës intelektuale nga Shqipëria gjatë periudhës së tranzicionit", Ilir Gëdeshi, Hekuran Mara, Rolanda Dhimitri, Ksenofon Krisafi, 1999.

Europës Perëndimore, midis të cilave Franca (me rreth 13 për qind) dhe Gjermania (me rreth 7 për qind) zënë një vend jo të parëndësishëm. Duhet theksuar fakti se një pjesë e intelektualëve të vendosur në Itali, kishin qëndruar këtu për një periudhë afatmesme dhe të gjatë (1-3 vjet) për specializime pasuniversitare para se të emigronin. Ndërsa, Kanadaja fillon e shfaqet në vitin 1994, duke përfaqësuar në fillim të vitit 1998 rreth 2.8 për qind të emigrimit të elitës intelektuale. Thellimi i këtyre prirjeve tregon se emigrimi i elitës intelektuale nga Shqipëria po merr gjithnjë e më shumë tiparet e një emigrimi të qëndrueshëm dhe të përhershëm.

4.2 Punësimi sipas sektorëve.

Tregu i punës, parë nga këndvështrimi i ofertës dhe kërkesës, ka njohur zhvillime të ndryshme (tabela 4).

Duke filluar nga viti 1994, sipas të dhënave zyrtare, shtesa natyrale e popullsisë ka njohur ritme rritjeje pozitive. Me rritje konstante, gjatë gjithë viteve të fundit, rezultojnë dhe popullsia në moshë pune si dhe fuqia e aftë për punë. Pa u ndalur në detaje të ritmeve të rritjes, nëse ato janë të larta apo të ulëta, të pranueshme apo me ekese, brenda apo jashtë aftësive absorbuese të ekonomisë sonë, në përgjithësi mund të konkludohet se shtesat në tre grupet e mësipërme janë vetëm në kufirin 1 për qind. Siç vihet re, mund të konkludohet se rritja e ofertës në tregun e punës ka qenë krejt natyrale.

Në anën tjetër vëmë re se numri i të punësuarëve, sidomos pas vitit 1994 ka regjistruar një rënie të vazhdueshme, e cila ka vazhduar edhe gjatë vitit 1999. Sipas të dhënave të fund vitit, llogaritet që numri i punësuarëve të jetë ulur më tej për rreth 4 mijë persona. Rritjes së ofertës për punësim i është përgjigjur një kërkesë në rënie të vazhdueshme, për rrjedhojë të së cilës papunësia vazhdoi të rritet më tej.

Sektori më me peshë për tregun e punës vazhdon të mbetet bujqësia, ku llogaritet se janë rreth 761 mijë fermerë të vetëpunësuar. Numri i madh i të punësuarve në këtë degë shpjegohet dhe me peshën e madhe që zë bujqësia në totalin e prodhimit të përgjithshëm. Nga ana tjetër, ecuria me ritme më të ulëta se në vitet e para të tranzicionit ka bërë që dhe kërkesa e këtij tregu për krahe pune të qëndrojë larg ofertës e për rrjedhim krijimi i vendeve të reja të punës në këtë degë akoma nuk është konkret. Vetë numri i të punësuarve në bujqësi përbën një të dhënë që duhet rishikuar. Edhe pse një numër i konsiderueshëm personash në bujqësi, kryesisht ata që kanë marrë tokë bujqësore, nuk janë të regjistruar si të papunë, në përgjithësi toka e marrë, bën të mundur që vetëm një anëtar i familjes të konsiderohet plotësisht i punësuar.

Në përgjithësi, **papunësia përbën një problem social të mprehtë, por megjithatë në Shqipëri reagimi ka qenë jo i ashpër. Mund të evidentohen dy faktorë që zbusin këtë problem social tejet problematik për çdo ekonomi, pavarësisht nga shkalla e zhvillimit të saj. Së pari, mund të përmendet **punësimi në sektorin joformal të ekonomisë dhe në ekonominë e rrugës**. Së dyti, pa dyshim më i rëndësishmi është **oferta e jashtme, emigracioni**, i cili në fund të vitit 1999, llogaritet në rreth 500 mijë vetë ose rreth 15 për qind e popullsisë së vendit. Shkalla e lartë e emigracionit, ka ndikuar edhe si një faktor zëvendësues i të ardhurave nga punësimi, duke kontribuar dy herë në zbutjen e presioneve ndaj qeverisë.**

Tabela 4. Tregues të punësimit.

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998*	1999**
Popullsia (000)	3190	3167	3202	3249	3283	3324	3354	3388
<i>Përqindja e rritjes së popullsisë</i>	-2,1	-0,7	1,1	1,5	1,1	1,3	0,9	1,0
Mosha e punës	1849	1763	1786	1820	1850	1861	1888	1907
Forca e aftë për punë	1489	1347	1423	1309	1274	1301	1320	1321
Të papunë gjithsej	394	301	262	171	158	194	235	240
<i>Përqindja e papunësisë</i>	26,5	22,3	18,4	13,1	12,4	14,9	17,8	18,0
Numri i të punësuarve	1095	1046	1161	1138	1116	1107	1085	1081
Bujqësi, gjueti, pyje, peshkim			779,6	777,9	784,5	770,8	768,5	761
Ind. nxjerrëse, përpunuese, ener.elektrike			110,8	94,9	85,2	88,2	84,2	
Ndërtim			18,2	21,3	21,5	15,2	11,0	
Transport dhe telekomunikacion			27,6	29,9	27,0	26,9	33,1	
Shërbime			42,3	61,9	77,7	58,0	34,4	
Mjeksi, arsim, të tjerë buxhetore			182,8	172,0	119,8	148,5	153,7	
Shkalla e pjesëmarrjes në %	80,5	76,4	79,7	71,9	68,9	69,9	69,9	
Meshkuj	85,7	85,9	90,4	84,6	82,1	85,5	84,9	
Femra	75,4	669,9	68,7	59,1	55,5	54,3	54,8	
*Burimi: Deri në vitin 1998 "Shqipëria në Shifra" INSTAT.								
**Burimi: Viti 1999 është marrë nga "KONJUKTURA" INSTAT.								

4.3 Të ardhurat.

Politika e pagave, pensioneve dhe përfitimit të pagesave të papunësisë, në sektorin publik të ekonomisë, ku ende vazhdon të punojë një numër i madh i popullsisë së vendit, mori në konsideratë zhvillimet e kaluara në inflacion, objektivin e tij për vitin 1999, si dhe vetë politikën globale të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore po për vitin e kaluar. Nga ana tjetër, në sektorin privat, megjithë mungesën e informacionit mbi atë se çfarë ndodh, përcaktimi i pagave është krejtësisht i lirë dhe ndikohet kryesisht nga tregu i punës dhe kërkesat e tij.

Vlerësohet se diferenca midis nivelit të pagave është në rritje në favor të ndërmarrjeve private krahasuar me ato shtetërore. Presionet e tregut dhe pavarësia që ndërmarrjet private kanë në përcaktimin e pagave bën që biznesi privat të jetë shumë më fleksibël në politikën e pagave jashtë kornizave të ngurta të politikave për pagat në sektorin shtetëror.

Edhe vendndodhja gjeografike vlerësohet të jetë një faktor tjetër që po ndikon në madhësinë dhe diferencat në paga. Ashtu si në tregun e punës, diferencat ndërmjet sektorëve industrialë dhe formave të pronësisë, ka çuar në diferenca në paga, sipas krahinave të vendit duke pasqyruar edhe shpërndarjen e industrisë në to.

Në fund të vitit 1999, paga mesatare mujore në sektorin shtetëror të ekonomisë arriti në nivelin 13193 lekë krahasuar me 10079 lekë në fund të vitit 1998. Rritja nominale e pagës mesatare në masën 31 për qind tregon se rritja e pagës për punonjësit e sektorit buxhetor dhe atyre jobuxhetor është shumë mbi nivelin 10 për qind të rritjes së shpallur nga qeveria në muajin prill 1999. Shkaqet që mund të shpjegojnë këtë fenomen janë të vështira për t'u identifikuar dhe ndoshta, në një farë mënyre, shprehin rritjet në koeficientë të ndryshëm të pagave në sektorin buxhetor, në ndërmarrjet shtetërore dhe të pensioneve.

Gjatë vitit 1999, në sektorin shtetëror, u ruajt i pandryshuar kufiri minimal i pagës nominale mujore 5800 lekë. Po të pandryshuara mbetën dhe pagesat për papunësinë dhe të ardhurat minimale për një familje me 4 veta përkatësisht në masën 2500 dhe 4800 lekë. Megjithëse niveli aktual i të tre pagesave të mësipërme reflekton mundësitë e financave të Shtetit Shqiptar, përsëri niveli i tyre është shumë i ulët dhe nuk ka nevojë për koment.

5. ÇMIMET E KONSUMIT DHE INFLACIONI

Për të dytin vit rradhazi inflacioni (matur me ndryshimin dymbëdhjetëmujor të indeksit të çmimeve të konsumit) vazhdoi të ulet me shpejtësi. Pasi regjistroi një nivel njëshifror në vitin 1998, vazhdoi të zbresë me shpejtësi në mënyrë konstante gjatë gjithë vitit, duke arritur në një përqindje prej -1,03 për qind.

Ekzistojnë ide të shumta, që përpiqen të gjejnë shkaqet e ecurisë së pazakontë të inflacionit gjatë vitit 1999. Mbi të gjitha do të veçonim fluksin e madh hyrës, në mallra dhe në valutë, që Shqipëria siguroi në të gjithë format e mundshme gjatë vitit të kaluar. Qeveritë e huaja, institucionet ndërkombëtare, organizmat bamirëse dhe vetë të shpërngulurit nga Kosova, u bënë një burim i konsiderueshëm të ardhurash valutore dhe mallra, ndërkohë që dhe hyrjet tradicionale ruajtën pothuaj të njëjtin ritëm. Për rrjedhim, kursi i këmbimit qëndroi stabël, me një tendencë të vazhdueshme drejt mbiçmimit, duke u bërë një faktor kyç në eliminimin e presioneve inflacioniste në terma afatshkurtër.

Politikat e aplikuara si dhe reformat e ndërmarra gjatë vitit 1999, vlerësohen të kenë dhënë kontributin e tyre në uljen e presioneve inflacioniste në ekonomi. Pa hyrë në detaje, mbetet për t'u verifikuar nëse këto politika do të jenë të dobishme në periudhë afatgjatë. Paaftësia për të ecur me shpejtësi dhe me efektivitet në reformat e programuara, gjithnjë e më shumë do të vërë në dyshim ecurinë afatgjatë të inflacionit.

Nuk përjashtohet dhe mundësia e pranisë së pasaktësive në llogaritje, sidomos për shkak të vjetërimit të metodologjisë së përpunimit të të dhënave. Duhet nënvizuar fakti se realiteti i fundvitit 1999, është shumë i ndryshëm nga ai i gjashtë viteve më parë. Ndryshim ka pësuar jo vetëm mënyra se si konsumojnë shqiptarët, por edhe kompozimi gjeografik i vendndodhjes së tyre. Është e domosdoshme të verifikohet nëse shqiptarët ende harxhojnë 73 për qind të të ardhurave të tyre për konsum ushqimor, ndërkohë që çmimet e mallrave të tilla si veshmbathje, elektroshtëpiake, pajisje dhe orendi, karburant, qira etj., zënë një peshë shumë të ulët. Nuk mund të shpjegohet ndryshe fakti që rritja aktuale e çmimit të naftës, nuk përbën problem për ekonominë tonë, ndërkohë që dhe ekonomitë më të forta janë shumë sensibil ndaj këtij fenomeni. Faktikisht, gjatë viteve të fundit, inflacioni është identifikuar thjesht me ndryshimin e çmimeve të frutave, perimeve, mishit, produkteve blegtorale etj..

Pa dashur të neglizhojmë grumbullimin e çmimeve në rrethet e tjera, do të theksojmë faktin së, në përgjithësi, kërkesa përcaktohet nga qyteti i Tiranës dhe dy-tre rrethe të tjera të mëdha. Në këtë kontekst, në qoftë se do të tregohet kujdes në monitorimin e çmimeve në qytetin e Tiranës, mund të thuhet se me një koeficient relativisht të lartë sigurie, inflacioni në Shqipëri është thjesht shifra që rezulton e korriguar me një koeficient elasticiteti.

Siç dihet, në Shqipëri efektet zhvlerësuese maten vetëm me anë të indeksit të çmimeve të konsumit, ndërkohë që janë lënë në harresë tregues të tillë si zhvlerësuesi i PBB-së, indeksi i çmimeve me shumicë, indeksi i çmimeve të eksport-importit etj.. Në këto rrethana, kufizohet analiza mbi ecurinë e çmimeve.

Rëndësia që ka ndjekja dhe përlllogaritja skrupuloze e inflacionit si dhe faktorëve që e ndikojnë atë, rritet më tepër kur shikon se norma e inflacionit ka kaluar poshtë asaj bande që teorikisht quhet e ulët (nivelit të vendeve të zhvilluara). Në këtë kontekst nuk mund të tolerohen pasaktësira të tipit një deri disa pikë përqindjeje, pasi në të kundërt gjithçka do të përmbysëj.

Duke përmbledhur sa më sipër, do të evidentonim edhe një herë se sfida me inflacionin nuk ka mbaruar. Eksperienca e dekadës së fundit fatkeqësisht është e mbrapshtë. Në këtë kuptim, për të mos përsëritur dhe një herë vitin 1996, ku inflacioni u rrit pothuajse 3 herë më shumë nga viti 1995, Banka e Shqipërisë vlerëson se vetëm respektimi rigoroz i objektivave dhe reformave ekonomike do të sigurojë stabilitet afatgjatë.

5.1 Faktorët e politikave ekonomike.

Në vitet e fundit, si pjesë e procesit të përcaktimit të objektivave të politikave ekonomike, është shpallur vazhdimisht objektivi për normën e inflacionit, i cili më konkretisht kupton ndryshimin dymbëdhjetëmujor në përqindje të indeksit të çmimeve të konsumit në fund të çdo viti kalendarik. Objektivi i vendosur shërben si një pikë referimi për vendimmarrësit dhe, nëpërmjet shpalljes së tij, synohet të stabilizohen pritjet inflacioniste në nivele të përafërta me objektivin. Në këtë kontekst, suksesi apo dështimi në arritjen e objektivit në shkallë të madhe varen nga politikat monetare dhe fiskale të ndjekura.

Ndërsa politikës fiskale në mënyrë konstante i kërkohet të pakësojë deficitin buxhetor si përqindje ndaj PPB-së, politikës monetare i kërkohet vënia nën kontroll e ofertës së parasë. Në të dy rastet pasoja evidentohet në tkurrje të kërkesës së brendshme dhe në lehtësim të presioneve në rritje ndaj çmimeve të konsumit.

5.1.1 Politika fiskale.

Politika fiskale, duke synuar reduktimin e deficitit buxhetor, ndikon në ecurinë afatshkurtër të çmimeve të konsumit. Parë nga konteksti i ndikimit afatgjatë, madhësia e borxhit publik, totali i deficitit buxhetor dhe mënyra e financimit të tij, përbëjnë faktorët që ndikojnë ecurinë e çmimeve të konsumit. Ndërsa në kuptim afatshkurtër, zhvillimet inflacioniste në një masë të madhe varen nga niveli i shpenzimeve publike, të cilat zënë një peshë të konsiderueshme të kërkesës agregate, dhe nga madhësia e deficitit buxhetor. Madhësia e deficitit buxhetor dhe shmangia ndaj nivelit të programuar të tij luajnë rol të konsiderueshëm në krijimin e presioneve inflacioniste në ekonomi.

Duke u zhvendosur në zhvillimet faktike të vitit 1999, në mënyrë të përgjithshme mund të thuhet se politika fiskale, në një masë të caktuar, ka ndihmuar në zbutjen e presioneve inflacioniste në terma afatshkurtër. Edhe pse vendi kaloi një ngjarje të pazakontë dhe të paparashikuar në program, me pasoja të drejtpërdrejta në vjeljen e taksave, përsëri reduktimet e bëra në anën e shpenzimeve ishin të atij niveli që arritën të ekuilibronin atë efekt, duke bërë që në fund të vitit 1999 të kishim një deficit buxhetor në masën 11 për qind të PPB-së, 2 pikë përqindjeje poshtë objektivit të vendosur.

Për më tepër mbulimi i deficitit buxhetor me burime të brendshme financiare regjistroi vetëm 4.9 për qind të PBB-së, rreth 1.6 pikë përqindjeje më pak se viti i kaluar dhe 1 pikë përqindjeje më pak se programi për vitin 1999.

Pavarësisht nga sa më sipër, vlerësimet e fundit për borxhin publik tregojnë se niveli i tij si shprehje relative ndaj PBB-së, ka mbetur i pandryshuar krahasuar me një vit më parë. Në këtë mënyrë, mund të konkludohet se në një këndvështrim

afatgjatë, ndikimi i politikës fiskale favorizon shtimin e presioneve inflacioniste në ekonomi.

5.1.2 *Politika Monetare.*

Që në momentin kur në ligjin "Mbi Bankën e Shqipërisë" u vendos shprehimisht se "Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë është të arrijë dhe të ruajë stabilitetin e çmimeve", natyrshëm që dhe politika, që ajo ka ndjekur, ka qenë në funksion të këtij objekti.

Normalisht, në një ekonomi tregu të hapur dhe të rregulluar (ekonomitë e zhvilluara), politika monetare merr jetë nëpërmjet përqindjes afatshkurtër të interesit, që banka aplikon kur krediton bankat tregtare. Në kushtet e ekzistencës së një ekonomie akoma pa fizionomi të plotë të tregut të lirë, transmetimi i politikës monetare bëhet shumë i vështirë e për rrjedhim, banka duhet të gjejë rrugë të tjera më të drejtpërdrejta, si rezervën e detyrueshme, kontrollin mbi kredinë dhe kontrollin administrativ mbi përqindjet që bankat ofrojnë për depozitat. Në linjë me këtë të fundit ka qenë dhe politika që Banka e Shqipërisë ka hartuar dhe ndjekur në vazhdimësi që nga krijimi i saj. Fillimisht u synua ndalimi "i hemoragjisë" monetare nëpërmjet kufizimeve të drejtpërdrejta në anën e aktivitetit. Për këtë qëllim, u adaptuan instrumente monetare të kontrollit të drejtpërdrejtë ku rolin kryesor për një periudhë disaveçare e luajti kufiri i kredisë. Me kalimin e viteve, sidomos në pikun e skemave piramidale, ky instrument u bë jorezultativ, ndërkohë që përqindjet e larta në tregun joformal kishin nxjerrë jashtë loje kontrollin administrativ mbi normat e interesit për depozitat. Ky efektivitet i ulët i politikës monetare, ndihmuar nga një zhvlerësim i fortë i Lekut, vazhdoi gjatë gjithë vitit 1997, në përfundim të të cilit inflacioni ariti në 42 për qind. Ndërkohë që, në muajt e fundit të vitit 1997, filluan të shfaqen shenjat e para se përqindja e interesit për depozitat në lekë me afat maturimi tremujor, kishte fituar atributin e përqindjes bazë të interesit e për rrjedhim, reagimi ishte i shpejtë dhe kjo u duk qartë që në mesin e vitit 1998, kur inflacioni ishte rreth 2.5 herë më i ulët.

Që nga ai moment e në vazhdim, Banka e Shqipërisë ka arritur që t'i transmetojë ekonomisë vendimet e saj. Megjithatë, duhet theksuar se ecuria e inflacionit po ndikohet në masë të konsiderueshme nga faktorë të tjerë jashtë politikës monetare. Edhe pse gjatë gjithë vitit, përqindjet e interesit të depozitave me afat në lekë, shënuan rënie të ndjeshme, përqindja e inflacionit, jashtë çdo parashikimi, ra me shpejtësi derisa regjistroi një nivel negativ.

Gjithësesi duhen mbajtur parasysh dhe faktori *shock* që gjatë vitit të kaluar u shfaq në formën e krizës në rajonin tonë. Pavarësisht se nuk ekzistojnë matje të sakta se në ç'masë inflacioni ndikohet nga efekte *shock*-ëve të kësaj natyre, tashmë pranohet nga të gjithë se zhvillimet e Lekut në vitin 1999, ndikuan në shkallë të madhe nga prurjet e jashtëzakonshme në mallra e valutë, ishin një faktor kyç në përcaktimin e inflacionit.

Box. 7: Inflacioni negativ.

Zhvillimet e inflacionit edhe në muajt e parë të vitit 2000 vazhdojnë të ruajnë tendencën e vërejtur gjatë vitit 1999. Norma vjetore e inflacionit rezulton negative për 1 për qind në fund të muajit shkurt 2000. Teorikisht, pranohej që në afat të shkurtër inflacioni negativ kufizon aftësinë e një vendi për krijimin e kapaciteteve të reja prodhuese dhe për rrjedhojë edhe për rritjen ekonomike të tij si dhe të punësimit.

Në rastin e Shqipërisë, ndryshe nga ekonomitë e zhvilluara, praktikisht nuk ka mundësi matjeje të lidhjes "inflacion - rritje ekonomike - rritje punësimi" në afat të shkurtër. Megjithatë, objektivat për ruajtjen e rritjes ekonomike mesatarisht në masën 8 për qind për dy-tre vitet e ardhshme dhe uljen e numrit të të papunëve, mund të rrezikohen nga vazhdimësia e mëtejshme e gjendjes deflacioniste në ekonomi. Me këtë nuk kuptohet që politikatat monetare dhe fiskale të shndërrohen në politika ekspansioniste. E rëndësishme është përsosja e mekanizmave të transmisionit, të tregjeve; një zhvendosjeje në strukturën e shpenzimeve buxhetore, nga korente në kapitale, dhe një zhvendosjeje e kreditimit, nga ai për qeverinë te kreditimi për sektorin privat të ekonomisë.

Duhet theksuar që ulja e presioneve inflacioniste në ekonomi, madje edhe poshtë objektivit të vendosur, është e vlefshme deri sa ky inflacion të arrijë nivelet teorike të "inflacionit të mirë" (d.m.th në intervalin 1-3 për qind). Gjykuar nga kjo pikëpamje dhe duke pasur parasysh ekonominë ende të pakonsoliduar të Shqipërisë, është e vlefshme që të ruhet niveli i inflacionit pozitiv pranë objektivit të vendosur.

5.2 Zhvillimet në indeksin e çmimeve të konsumit.

Viti 1999, filloi në kushtet e një inflacioni njëshifror me një objektiv jo shumë larg shifrës së fundvitit 1998. Në përputhje me gjithë objektivat e tjerë finalë të programit afatmesëm të zhvillimit të vendit (rritjen e prodhimit në masën 8 për qind dhe një deficit të llogarisë korente në masën 11.2 për qind të PBB-së) u vendos si objektiv për ndryshimin dymbëdhjetëmujor të IÇK niveli 7 për qind.

Zhvillimet e muajve të parë dhanë shenja të qarta për një nivel çmimesh poshtë atij të programuar, megjithë panikun që shkaktoi në fillim të tremujorit të dytë shpërthimi i konfliktit në Kosovë. Në fund të muajit qershor, për gjithë periudhën gjashtëmujore, çmimet u ulën në mënyrë të ndjeshme dhe ndoshta të papritur me 2,8 për qind.

Gjashtëmujori i dytë përkon me largimin e shpejtë të popullsisë së Kosovës, dhe për rrjedhim vëmendja dhe rrjedhja e ndihmave të komunitetit ndërkombëtar u përqendrua në Kosovë. Nga ana tjetër, ulja e normave të interesit vazhdoi me shpejtësi duke manifestuar në këtë mënyrë shenja të qarta të një zbutjeje të matur të politikës monetare nga ana e Bankës së Shqipërisë. Për pasojë, gjashtëmujori i dytë regjistroi një përqindje pozitive inflacioni në kufirin e shifrës 1.9, duke çuar kështu në një normë vjetore në masën -1.03 për qind.

Tabela 5. Inflacioni matur në disa mënyra të ndryshme (%).

	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999
Norma 12-mujore e inflacionit	236,58	30,94	15,82	6,01	17,41	42,07	8,69	-1,03
Objektivi								7,00
Inflacioni bazë			7,84	4,87	9,66	38,32	6,63	-2,91
Inflacioni përjashtuar grupin "ushqim, pije & duhan"			37,77	5,39	10,04	36,14	7,32	-1,89

Burimi: INSTAT & Banka e Shqipërisë.

Të njëjtat zhvillime paraqiten dhe në disa matje të tjera për inflacionin të bërë nga Banka e Shqipërisë. Në rastin e inflacionit bazë, vihet re se përqindja në fund të vitit, rezulton rreth 3 herë më e ulët, ndërkohë që në rastin kur nuk është marrë në konsideratë grupi "ushqim, pije dhe duhan" inflacioni dymbëdhjetëmujor është diçka midis dy matjeve të mëparshme.

Box. 8: Inflacioni bazë.

Inflacioni përjashtuar grupin grupin "ushqim, pije dhe duhan".

Në tabelën 6 është pasqyruar ecuria e inflacionit për atë pjesë të shportës, e cila mbetet mbas heqjes së grupit "ushqim, pije dhe duhan". Normalisht grupi "ushqim pije dhe duhan" zë rreth 73 për qind të totalit të shportës e për rrjedhin ndryshimet në këtë grup përcaktojnë dhe normën e inflacionit në Shqipëri. Për të ndërtuar një tregues inflacioni më të lidhur me paranë, Banka e Shqipërisë ka ndërtuar disa përafrime të inflacionit bazë, një ndër të cilët është dhe skenari i paraqitur në tabelën e mëposhtme. Dihet që çmimet e këtij grupi janë shumë të luhatshme, ndonëse kjo luhatshtëri ndryshon për nëngrupet e veçanta. Ky fakt është marrë në konsideratë e për rrjedhim janë ndërtuar disa variante ku përjashtime janë bërë vetëm në nëngrupin bukë dhe drithëra, nëngrupin ushqime me karakter stinor, dhe për të tërë grupin "ushqim, pije dhe duhan". Konkretisht i jemi referuar rastit të fundit ku evidentohet qartë se ku shkon pjesa më e madhe e shpenzimeve të shqiptarëve, sigurisht pas shpenzimeve për ushqim.

Tabela 6. Llogaritja e inflacionit bazë përjashtuar grupin "ushqim, pije dhe duhan".

Peshat e reja të normalizuara	1,000	Ndryshimi 12-mujor	Kontributi në inflacion
Veshje dhe këpucë	0,102	1,66	0,17
Qira, ujë, karburant dhe energji	0,232	2,87	0,67
Mallra individësh	0,300	-8,35	-2,50
Kujdes mjeksor	0,033	12,80	0,43
Transport dhe komunikacion	0,187	2,28	0,43
Argëtim, edukim dhe kulturë	0,129	-7,87	-1,02
Kujdes personal	0,017	4,12	0,07
Inflacioni			-1,80
Burimi: Banka e Shqipërisë			

Siç shihet nga tabela, pesha që zënë grupet e shportës në rastin kur përjashtojmë totalisht grupin "ushqim, pije dhe duhan", rritet shumë në favor të grupit "mallra individësh", rreth 30 për qind e shportës. Fakti që mallra të tilla si veshje, këpucë, medikamente, kozmetikë, edukim, argëtim, kulturë, janë përfshirë në grupe të veçanta, kuptohet që në këtë zë mbeten mallra të tillë si elektroshtëpiake, mobilie dhe orendi. Më hollësisht kjo do të thotë që nëse nga shporta e mallrave do të hiqet grupi i shpenzimeve "ushqim, pije dhe duhan", atëherë shpenzimet e shqiptarëve do të shpërndareshin sipas tabelës së mësipërme, ku 30 për qind e totalit të shpenzimeve do të harxhohej për pajisje elektroshtëpiake, mobilie dhe orendi. Të dhënat e tregtisë së jashtme flasin për rënie konstante të importeve në këto zëra ndërkohë që për zëvendësimin e tyre me prodhim vendas as që bëhet fjalë. Edhe rënia e mundshme në çmimin e tyre pasqyron, në njëfarë mase, uljen e kërkesës për këtë grup mallrash. Vetë të dhënat e INSTAT-it mbështesin këtë argumentim dhe fakt është që fenomeni është shumë tipik për fillimin e viteve '90. Nga sa më sipër kuptohet që ndikimi i këtij grupi është i dyshimtë dhe mund të konkludohet se nuk mbart realitetin e fundshekullit të kaluar.

Tabela 7. Shporta e artikujve të IÇK.

	Peshat	12,5 %*	25%**
Inflacioni		-2.02	-2,91
Totali i artikujve	1,0000	1,0000	1,0000
Bukë dhe drithra	0,1547	0,201	0,257

Mish, të imta dhe peshk	0,1328	0,173	0,221
Prodhime blegtorale dhe vezë	0,1299	0,169	0,0
Vaj dhe yndyrna	0,0715	0,093	0,119
Fruta dhe perime	0,1495	0,0	0,0
Sheqer, kafe, çaj	0,0402	0,052	0,067
Pije	0,0198	0,026	0,033
Pije dhe ushqim jashtë shtëpisë	0,0088	0,011	0,015
Duhan	0,0167	0,022	0,028
Veshje dhe këpucë	0,0282	0,037	0,047
Qira, ujë, karburant dhe energji	0,0641	0,083	0,106
Mallra individësh	0,0827	0,0	0,0
Kujdes mjeksor	0,0092	0,012	0,015
Transport dhe komunikacion	0,0516	0,067	0,086
Argëtim, edukim dhe kulturë	0,0357	0,046	0,0
Kujdes personal	0,0046	0,006	0,008

*Mesatarja e 12,5 për qind së qendrës së shpërndarjes së inflacionit mujor (duke përdorur peshat e ponderuara të IÇK)

**Mesatarja e 25 për qind së qendrës së shpërndarjes së inflacionit mujor (duke përdorur peshat e ponderuara të IÇK)

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pa u ndalur në hollësi do të theksonim se në të dyja rastet peshat e reja të përfuara pas zbritjeve, vazhdojnë të dominohen nga artikujt ushqimorë, me një rritje të mëtejshme të peshës së tyre ndaj totalit (përkatësisht në 74 dhe 78 për qind të totalit të shportës së re). Për rrjedhim dhe shifrat e inflacionit për vitin 1999, të matura me të dyja mënyrat, janë negative në nivele më të ulëta se vetë inflacioni vjetor pa përjashtime.

Inflacioni bazë.

Në tabelën 7, janë pasqyruar dhe dy mënyra të tjera të matjes së inflacionit bazë. Në kolonën e parë është evidentuar matja e inflacionit kur nuk merret në konsideratë 12,5 për qind e ndryshimeve ekstreme (pozitive dhe negative) në nëngrupet e zërit "ushqim, pije dhe duhan" dhe grupet e tjera të mbetura të shportës.

Në logjikën e kësaj matjeje dhe asaj në vijim është eliminimi i zërave më të ndryshueshëm të shportës duke konturuar kështu një llogaritje më të besueshme për treguesin e inflacionit. Në rastin e parë është përjashtuar vetëm një artikull në çdo ekstrem (dy në total) dhe në rastin e dytë janë përjashtuar nga dy zëra për çdo ekstrem si pozitiv ashtu dhe negativ (katër në total).

Box. 9: Disa të dhëna statistikore për inflacionin në Shqipëri matur si ndryshim dymbëdhjetëmuor i IÇK (dhjetor 1993 – dhjetor 1999)

Për periudhën 1994 - 1999 përqindja mesatare vjetore e inflacionit është luhatur nga 0,4 në vitin 1999 në 32,9 në vitin 1997. Shihet se viti 1999 paraqet vlerat më të ulëta të inflacionit të para ndonjëherë gjatë periudhës në fjalë. Jo vetëm kaq, por gjatë vitit 1999, ky inflacion ka qenë më i qëndrueshëm (me më pak luhatje) në krahasim me vitet e tjera (devijimi standard nga vlera mesatare ka qenë vetëm 2,3). Ndërsa luhatshmërinë më të lartë e paraqet viti 1998 (devijimi standard për këtë vit është në masën 11.5). Kjo është pasojë e reduktimit të ndjeshëm që pësoi inflacioni gjatë këtij viti duke u ulur nga 42.1 për qind në fund të vitit 1997 në 8.7 për qind në fund të vitit 1998 dhe për pasojë e ndryshimeve të mëdha në vlerën e inflacionit nga një muaj në tjetrin. Vlera mesatare e gjithë periudhës, prej 16,7 për qind, konsiderohet relativisht e lartë. Megjithatë, në rastin e Shqipërisë kjo mesatare nuk është shumë sinjifikative. Ajo bart në vetvete influencën e gjithë viteve të periudhës së studiuar, të cilët paraqesin shumë luhatje dhe ku norma e inflacionit ka rezultuar nën ndikimin e faktorëve specifikë për atë vit. Luhatshmërinë e normave vjetore të inflacionit e tregon dhe niveli relativisht i lartë i devijimit standard mesatar në masën 12.9. Siç shihet nga tabela, viti 1999 është viti më i qëndrueshëm dhe më pak inflacionist, ku është arritur dhe vlera më minimale prej - 1,9 për qind. Ndërkohë, vlera më maksimale e inflacionit për gjithë periudhën është arritur në vitin 1998 me 44.6 për qind.

Duke u bazuar në treguesin e asimetrisë së shpërndarjes së vlerave të normës së inflacionit, vërehet që gjatë periudhës në fjalë prirja ka qenë më e dukshme drejt pasjes së normave të ulëta të inflacionit (asimetri të djathtë të shpërndarjes së vlerave, e cila është më e dukshme në vitin 1999). Përrjashtim bën vetëm viti 1997 (paraqet asimetri të majtë) ku prirja ka qenë drejt rritjes së inflacionit.

	Mesatarja	Devij. standard	Vlera maksimale	Vlera minimale	Varianca	Shmangia
1994	23,0	8,4	37,8	13,7	71,2	0,67
1995	8,0	5,1	16,2	2,1	25,6	0,85
1996	12,8	5,9	20,7	5,7	34,7	0,04
1997	32,9	7,4	42,1	16,9	55,2	-1,13
1998	21,6	11,5	44,6	8,7	132,3	0,92
1999	0,4	2,3	6,0	-1,9	5,5	1,50
12.1993 - 12.1999	16,7	12,9	44,6	-1,9	166,5	0,48

6. DEFICITI BUXHETOR

Konsolidimi fiskal përbën një nga detyrat më të vështira për çdo ekonomi, qoftë edhe për ato më të zhvilluarat. Gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, konsolidimi fiskal për gjithë ekonominë në tranzicion ka njohur ecuri me oshilacione, duke reflektuar në masë të madhe nivelin ende jo të konsoliduar të demokracisë në këto vende. Sipas të dhënave më të fundit të BERZH, konsolidimi fiskal, gjatë vitit 1999, njohu zhvillime të ndryshme në vende të ndryshme, nga ku lehtësisht u evidentua se në vendet me fushata elektorale dhe ato pranë konfliktit ballkanik, konsolidimi fiskal u vu në pikëpyetje, ndërkohë që në pjesën tjetër të vendeve ecuria ishte e suksesshme.

Pavarësisht nga kjo, në fund të vitit 1999, madhësia më e lartë absolute e deficitit buxhetor në përqindje ndaj PBB-së u regjistrua në Shqipëri me rreth 11 për qind.

Gjithësesi, deficitit fiskal mbeti nën kufijtë e planifikuar, me një çrregullim në vjeljen e taksave, i cili më së shumti u balancua nga shkurtime në shpenzimet e programuara, veçanërisht në shpenzimet kapitale. Të ardhurat nga taksat ishin në masën 6,5 miliardë lekë (1,6 për qind e PBB-së) poshtë programit. Ky deficit i krijuar, në masën rreth 50 për qind, mund të konsiderohet si efekt i drejtpërdrejtë i një norme inflacioni shumë poshtë atij të planifikuar dhe i një Leku shumë të fortë gjatë gjithë periudhës. Pjesa e mbetur vlerësohet të jetë pasojë e problemeve të vazhdueshme, që kanë të bëjnë me administrimin doganor, kontrabandën, korrupsionin pa harruar rritjen e madhe të importeve të pataksueshme gjatë periudhës së krizës së Kosovës.

Tabela 8. Llogaritë e buxhetit në % ndaj PBB-së.

	1990	1991	1992	1993	1994	1995	1996	1997	1998	1999*	1999
Totali i të ardhurave**	46,8	31,5	24,7	26,7	24,1	23,4	18,3	16,5	16,9	18,4	17,1
Nga taksat	42,2	26,8	16,7	16,6	16,0	13,2	10,7	9,8	12,3	14,1	12,5
Totali i shpenzimeve**	62,1	62,2	46,2	40,4	33,1	33,6	31,3	29,5	27,3	31,4	28,1
Konsumi	18,5	22,1	20,7	13,9	14,1	13,3	12,4	11,3	10,2	10,7	9,7
Deficiti primar	3,4	-24,5	-17,3	-4,8	-5,5	-1,9	-6,6	-8,6	-5,2	-4,4	-4,5
Investimet	18,8	6,1	4,2	9,0	3,4	8,3	6,3	4,4	5,3	7,5	6,4
Deficiti	-3,7	-43,9	-21,3	-13,7	-9,0	-10,2	-13,0	-13,0	-10,4	-13,0	-11,0
Financimi i jashtëm			0,3	4,5	0,4	3,7	2,8	1,9	3,8	7,1	6,1
Financimi i brendshëm	3,7	43,9	21,0	9,3	8,6	6,5	10,2	11,2	6,6	5,9	4,9

*-Programi i vitit 1999.

**-Llogaritë e sigurimeve shoqërore janë evidentuar për neto.

Burimi i të dhënave: Ministria e Financave.

Realizimi i shpenzimeve poshtë kuotave të planifikuara, përveç një ndikimi të drejtpërdrejtë në tkurrjen e kërkesës agregate (sidomos në pjesën e investimeve) çoi në ulje të nevojave për financim, gjë që reflektohet në një realizim rreth 2 miliardë lekë më të ulët të financimit të brendshëm nga ç'ishte planifikuar.

Statistikat e llogarive të qeverisë, në fund të vitit 1999, pasqyronin një pamje më optimiste ku mbi të gjitha spikat reduktimi i deficitit buxhetor të financuar me burime të brendshme në masën 4,9 për qind të PBB-së, krahasuar me 6,6 për qind në vitin e kaluar dhe 5,9 për qind në program.

Shpenzimet në total regjistruan nivelin 28,1 për qind. Pjesën më të madhe të tyre e zuri konsumi i qeverisë për rreth 10 për qind. Përsëri gjatë vitit 1999, realizimi i shpenzimeve njohu një ritmikë të çrregullt. Në rritje të vazhdueshme gjatë vitit 1999, ato rezultuan me nivelin e tyre më të lartë në tremujorin e fundit. Rreth 32,6

për qind të tyre u realizuan në këtë tremujor, ndërkohë që mesatarisht në tre tremujorët e tjerë pati një realizim të tyre në masën 22,5 për qind. Ky disproporcion i shpërndarjes së shpenzimeve gjatë periudhës njëvjeçare solli vështirësi në aspektet e dukshme të politikës monetare, sepse dihet që në fund të vitit nevojat për likuiditete nga buxheti janë shumë më të larta se sa në pjesën tjetër të tij. Ndikimi negativ i këtij fenomeni mund të shfaqet edhe në treguesin e inflacionit të pritshëm. Ndërkohë që është punuar për uljen e normës së inflacionit me anë të mekanizmave fiskale gjatë vitit, rritja e dukshme e shpenzimeve në tremujorin e katërt reflektoi në nivelin e këtij treguesi që në tremujorin e parë.

Tek të ardhurat, ka një ritmikë më të rregullt të shpërndarjes sipas tremujorëve. U vu re një ulje tyre në tremujorin e dytë, për shkak të fillimit të krizës kosovare dhe më pas, si pasojë e prezencës së të ardhurave nga fondi kundërparti, pati një rritje të lehtë të tyre në muajt prill dhe maj. Niveli i të ardhurave rezultoi në masën 89.6 miliardë lekë dhe rreth 73 për qind e tyre u realizuan nga të ardhurat prej taksave.

Treguesi i të ardhurave, i krahasuar me PBB-në në vitin 1999, shënoi një rritje të lehtë në krahasim me një vit më parë. Sidoqoftë, në vlerë absolute, të ardhurat nga tatim taksat janë me mosrealizime, gjë që nxjerr në dukje, edhe një herë, problemin e punës në dogana, kontrabandën, korrupsionin etj..

Shpenzimet totale të krahasuara me PBB-në shënuan një rritje absolute të ndjeshme, në masën 7.2 për qind krahasuar me vitin 1998, pavarësisht se në krahasim me nivelin e tyre të parashikuar ato u ulën në rreth 3.3 për qind.

7. BILANCI I PAGESAVE DHE REZERVA VALUTORE

Është e vështirë të perifrazosh me një fjalë të vetme zhvillimet në pozicionin e jashtëm të vendit. Të dhënat më të fundit të bilancit të pagesave flasin për një deficit në rritje të llogarisë korente, i cili, gjithësesi, është mbuluar nga të hyrat e larta në zërat tradicionalë, në llogarinë kapitale dhe atë financiare.

Viti 1999 nisi me zhvillime të balancuara e nën kontroll, të cilat u përforcuan gjatë tremujorit të dytë me rritjen e të ardhurave nga turizmi dhe ndihma e huaj. Për rrjedhim, gjashtëmujori i parë u mbyll me një suficit korent rreth 48 milionë dollarë amerikanë.

Në gjysmën e dytë të vitit rritja e deficitit tregtar të mallrave dhe rënia e të ardhurave nga eksporti i shërbimeve dhe dërgesave nga emigrantët shkaktuan një deficit korent prej 203.5 milionë dollarë amerikanë. Për rrjedhim, sektori i jashtëm humbi pjesërisht përparësitë e akumuluar gjatë gjysmës së parë të vitit dhe llogaria korente u mbyll me një deficit prej 155.1 milionë dollarë amerikanë.

Krahasuar me vitin paraardhës, deficitin e transaksioneve korente u rrit 3.4 herë dhe përfaqëson 4,1 për qind të PBB-së kundrejt 1,5 në vitin 1998. Thellimi i deficitit korent është shkaktuar kryesisht nga rritja e shpenzimeve korente 28 për qind kundrejt vetëm 16 për qind rritjeje të të ardhurave korente, duke përmbysur situatën e një viti më parë kur të ardhurat u rritën tre herë më shumë se shpenzimet. Deficiti i transaksioneve korente, përjashtuar transfertat shtetërore, është rritur 2.3 herë kundrejt vitit 1998. Ndër shkaqet kryesore për rritjen e deficitit korent mund të përmendet rritja e deficitit tregtar dhe rënia e dërgesave prej emigrantëve, të cilat eklipsuan rritjen e jashtëzakonshme të të ardhurave në transaksionet e shërbimeve.

7.1 Zhvillimet në llogarinë korente dhe bilancin e pagesave.

Vëllimi i tregtisë së jashtme në mallra, gjatë vitit 1999, u rrit 19 për qind dhe u shoqërua me një deficit tregtar 10 për qind më të lartë se një vit më parë. Deficiti tregtar, në fund të vitit vlerësohet rreth 663 milionë dollarë amerikanë. Ai përfaqëson 17 për qind të PBB-së kundrejt 20 për qind në vitin 1998.

Eksportet, për vitin 1999, vlerësohen rreth 275 milionë dollarë amerikanë dhe përfaqësojnë një shifër 32 për qind më të lartë se një vit më parë. Kjo rritje, u sigurua kryesisht prej rritjes së eksporteve nga përpunimi aktiv, 52 për qind kundrejt vitit 1998, ndërkohë që prodhimi i brendshëm dha një kontribut minimal. Eksportet nga prodhimi i brendshëm u rritën vetëm 5 për qind. Për rrjedhim, struktura e eksportit ka ndryshuar në favor të riekksporteve nga përpunimi aktiv, të cilat për këtë vit përfaqësojnë 67 për qind të totalit të tij, kundrejt 58 për qind në vitin 1998. Eksportet nga përpunimi aktiv mbetën të përqendruara në grupmallrat tekstile e këpucë, të cilat së bashku përfaqësojnë rreth 90 për qind të vëllimit të këtyre eksporteve. Pjesa tjetër përfaqëson eksporte në formën e ushqimeve të përgatitura dhe pajisje elektrike, që gjatë vitit 1999 janë dyfishuar kundrejt vitit 1998.

Eksporti i brendshëm edhe këtë vit, u përqendrua në produktet minerale, metale, produkte vegjetale dhe duhan. Eksportet e mineraleve, që përfaqësojnë grupin më të madh në këtë kategori (19 për qind të eksporteve të brendshme kundrejt 27 për qind në vitin 1998), kanë rënë 25 për qind kundrejt një viti më parë. Ndër grupet e tjera të eksportit, që kanë rënë, mund të përmendim eksportet e bimëve medicinale

dhe duhanit përkatësisht 21 dhe 29 për qind më pak kundrejt vitit 1998. Efektet negative të grupmallrave të mësipërm janë zbutur prej rritjes së eksporteve në grupmallrat e tjerë. Ndikimin kryesor e ka dhënë rritja e eksporteve të metaleve bazë 17 për qind; të makinerive e pajisjeve, që janë rritur gati dy herë; lëkura dhe druri që janë rritur 5 dhe 12 për qind etj..

Viti 1999 solli zgjerimin e eksporteve me Italinë 33 për qind kundrejt vitit 1998. Eksportet me Gjermaninë u rritën, gjithashtu, 32 për qind. Në të dyja rastet, zgjerimi i tregut të eksporteve është mundësuar kryesisht prej rritjes së rieksperteve nga përpunimi aktiv. Eksportet me Greqinë kanë rënë 4 për qind, ku përveç rënies së rieksperteve nga përpunimi aktiv, ka ndikuar edhe rënia e eksporteve të duhanit.

Box. 10: Eksportet shqiptare në Kosovë.

Mendohet se eksportet me destinacion Kosovën, të paktën për tremujorin e tretë, nuk pasqyrohen ose pasqyrohen pjesërisht në statistikat doganore. Arsyeja për këtë është se për një periudhë relativisht të gjatë kohe (deri në muajin tetor) nuk ka pasur kufij doganorë dhe një pjesë e mirë e eksporteve kanë formën e *shuttle trade*¹⁴. Për pasojë, këto eksporte nuk janë pasqyruar në statistikat doganore dhe në ato të tregtisë së jashtme në bilancin e pagesave. Nga momenti i fillimit të funksionimit të pikave kufitare, Kosova është evidentuar si një prej partnerëve kryesorë në eksporte (i katërti).

Importet për vitin 1999 vlerësohen rreth 938 milionë dollarë amerikanë ose 16 për qind më të larta se një vit më parë. Niveli i lartë i importeve u nxit kryesisht prej rritjes së kërkesës së brendshme dhe rritjes së importeve ndihma. Ai është mbështetur kryesisht prej transfertave korente private dhe shtetërore, suficiti i shërbimeve të turizmit dhe rritja e detyrimeve kundrejt botës në formën e kredive. Rritja e vëllimit të përgjithshëm të importit nuk ka çuar në ndryshime të strukturës së mallrave të importuar. Importet kryesore mbeten importet në tekstile e këpucë (rreth 71 për qind e tyre janë importuar si mallra për përpunim aktiv), grupmallrat ushqimorë, makineri dhe pajisje, produktet vegjetale, produkte minerale dhe metale. Me përjashtim të importeve për përpunim aktiv, të gjithë grupmallrat e tjerë të importit janë rritur kundrejt vitit 1998. Rritjen më të madhe ndër të gjithë grupmallrat, e ka regjistruar grupi "ushqim, pije, duhan" (rreth 49 për qind) dhe grupi "makineri e pajisje" (rreth 34 për qind).

Partneri kryesor i Shqipërisë në importe mbetet Komuniteti Europian. Megjithatë, viti 1999 evidentoi rritjen e aktivitetit tregtar për importet nga tregjet në lindje. Importet nga Turqia janë rritur 86 për qind; nga Bullgaria 21 për qind; nga Maqedonia 54 për qind. Të treja këto shtete, së bashku, përbëjnë 10 për qind të tregut të importeve. Brenda Komunitetit Europian ka pasur një zhvendosje të tregut të importeve nga Italia në favor të Greqisë, e cila okupoi 28 për qind të totalit të importit. Importet greke janë rritur 12 për qind, duke pasqyruar kryesisht rritjen e importit të karburanteve dhe duhanit. Megjithëse Italia mbetet partneri kryesor edhe në importe, këtë vit okupoi vetëm 37 për qind të importit kundrejt 42 për qind në vitin 1998.

Viti u mbyll me një bilanc pozitiv shërbimesh prej 106 milionë dollarë amerikanë, i cili përmbysi tendencën historike të deficiteve të tregtisë së

¹⁴ Termi "shuttle trade" (tregtia me valixhe) nënkupton tregtinë që kryhet në shuma të vogla dhe që shfaqet si efekte personale.

shërbimeve. Pas këtij bilanci, thellësisht pozitiv, qëndron rritja jashtëzakonisht e lartë e të ardhurave nga aktiviteti i turizmit. Arkëtimet nga shërbimet e turizmit vlerësohen 211 milionë dollarë amerikanë, të barabarta me 5.6 për qind të PBB-së. Kjo rritje është mundësuar prej numrit jashtëzakonisht të lartë të turistëve¹⁵, që kanë hyrë në Shqipëri veçanërisht në tremujorin e dytë dhe të tretë të vitit 1999. Kriza kosovare tërhoqi në Shqipëri median botërore, organizatat ndërkombëtare, agjenci ndihmash humanitare, trupa ushtarake, të cilët, gjithashtu, kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave nga shërbimet.

Zhvillimet në tregtinë e "shërbimeve të tjera" reflektojnë kryesisht ecurinë e aktivitetit të turizmit. Ekspansioni i menjëhershëm i aktivitetit turistik ndikoi fuqishëm në rritjen e të ardhurave nga shërbimet e tjera, kryesisht shërbimet e komunikacionit dhe shërbimet qeveritare, respektivisht 21 për qind dhe 4.3 herë. Për rrjedhim, kategoria "shërbime të tjera" u mbyll me një suficit prej 11.5 milionë dollarë amerikanë, kundrejt deficitit prej 2 milionë në vitin 1998. Rritja e vëllimit të importeve çoi në mënyrë të pashmangshme në rritjen e deficitit të shërbimeve të transportit dhe atyre të sigurimit, respektivisht rreth 20 dhe 15 për qind. Kjo, pasi zhvillimet në këto kategori shërbimesh diktohen nga ecuria e shërbimeve të transportit të mallrave dhe shërbimeve të sigurimit, deficiti i të cilave shkon në korrelacion të plotë me rritjen e importit të mallrave.

Të ardhurat valutore të siguruara prej punës së emigrantëve sezonalë apo punëtorëve të zonave kufitare dhe investimit të mjeteve valutore në formën e depozitave me institucionet financiare jorezidente, mundësuan një bilanc pozitiv prej 75 milionë dollarësh amerikanë, vetëm 2 milionë më pak se viti 1998. Me përjashtim të rritjes së interesave të pagueshme për depozitat e jorezidentëve në sistemin bankar, të cilat janë shkaktuar prej rritjes së detyrimeve të sistemit bankar ndaj jorezidentëve, zhvillimet në llogarinë e të ardhurave korente nuk reflektojnë ndonjë fenomen, i cili vlen të evidentohet. Vlerat e transaksioneve, në të gjithë treguesit e tjerë mbetën pothuajse të pandryshuara kundrejt një viti më parë.

Bilanci pozitiv i transfertave korente në fund të vitit vlerësohet 37 për qind më i ulët se në vitin 1998. Megjithatë, ato mbeten zëri kryesor financues brenda llogarisë korente duke mbuluar rreth 49 për qind të deficitit tregtar të mallrave. Tkurrja e suficitit të transfertave korente erdhi si rezultat i kombinuar i rritjes së transfertave private në dalje dhe rënies së dërgesave nga emigrantët. Emergjencia humanitare, e provokuar prej krizës në Kosovë, shkaktoi rritjen e menjëhershme të transfertave korente shtetërore, të cilat vlerësohen 73 për qind më të larta se në vitin 1998. Veçanërisht e lartë ishte rritja e transfertave në *cash* dhe e ndihmave në mallra, respektivisht 8.6 herë dhe 41 për qind. Këto transferta përfaqësojnë kryesisht ndihmën e Komunitetit European në mbështetje të buxhetit të qeverisë për përballimin e situatës emergjente.

Megjithëse, transfertat shtetërore pothuajse u dyfishuan, ato nuk mundën të kompensonin rënien e dërgesave prej emigrantëve rreth 21 për qind dhe rritjen e flukseve dalëse të transfertave korente më shumë se tre herë kundrejt vitit 1998.

¹⁵ Për qëllime të statistikave të bilancit të pagesave, popullsia kosovare që qëndroi në Shqipëri gjatë konfliktit në Kosovë klasifikohet si "turistë". Për pasojë shpenzimet e tyre regjistrohen si "të ardhura nga turizmi".

Rënia e dërgesave, nën parashikimet optimiste të bëra në fillim të këtij viti, mund të shpjegohet me hyrjet e larta në mjete valutore të injektuara në ekonomi prej popullsisë kosovare dhe organizatave të huaja. Këto hyrje, mendohet se kanë luajtur një rol zëvendësues për dërgesat e emigrantëve. Statistikat e sistemit bankar tregojnë se dërgesat e transfertave përmes kanaleve bankare janë rritur, më shumë se dy herë, kundrejt vitit të kaluar. Megjithatë, vlerësohet se mjetet valutore nuk mbetën në banka, por së bashku me një pjesë të konsiderueshme të dërgesave të emigrantëve, të cilat hyjnë në formën e *cash-it*, qarkullojnë jashtë sistemit bankar duke nxitur rritjen e deficitit tregtar.

Llogaria kapitale dhe financiare, në fund të vitit, regjistroi një bilanc pozitiv prej 74 milionë dollarë amerikanë. Hyrja e kapitaleve, rreth 24 për qind më e lartë se në vitin 1998, reflekton kryesisht rritjen e detyrimeve prej huamarrjes dhe depozitave të jorezidentëve në sistemin bankar, respektivisht 34 për qind dhe 4 herë më shumë se në vitin 1998. Gjatë vitit 1999, u disbursuan në formën e kredive dhe të huave 146.5 milionë dollarë amerikanë, nga të cilat 20.9 milionë përfaqësojnë përdorim kredish e huash nga FMN. Kreditorët kryesorë të ekonomisë shqiptare janë Banka Botërore dhe Komuniteti European. Disbursimet e kredive të huaja janë bërë kryesisht në favor të Qeverisë Shqiptare, e cila ka thithur rreth 86 për qind të totalit të tyre, pjesa e mbetur ka shkuar në favor të sektorëve të tjerë dhe të autoritetit monetar.

Investimet e huaja kanë luajtur një rol të dorës së dytë në financimin e transaksioneve korente. Importet e kapitaleve nga investimet e huaja direkte mbetën nën ndikimin situatës së rënduar në rajon dhe vlerësohen nën nivelin e vitit 1998. Importi i konsiderueshëm i kapitalit u shoqërua paralelisht edhe me akumulim e eksportim mjetesh valutore, që vlerësohet rreth 130 milionë dollarë amerikanë.

Rezervat e autoritetit monetar gjatë vitit u rritën me 123.6 milionë dollarë¹⁶ amerikanë. Stoku i tyre, në fund të vitit, ishte i mjaftueshëm për të përballuar 5.2 muaj importe. Faktorët kryesorë, që kanë çuar në rritjen e rezervave valutore, janë disbursimet e kredive të huaja dhe ndihmat në *cash* të dhëna Qeverisë Shqiptare për mbulimin e kostos së krizës, kryesisht gjatë tremujorëve të dytë e të tretë të këtij viti.

Viti 1999 është mbyllur me një shifër shumë të lartë në zërin "Gabime dhe Harresa". Banka e shqipërisë e komenton këtë shifër si mangësi në statistikat zyrtare dhe financimit të sektorit të jashtëm nga aktivitete të papërcaktuara joformale.

Box. 11: Prurjet valutore shtesë gjatë periudhës së krizës.

Shpërthimi i dhunës serbe në Kosovë u shoqërua me shpërngulje masive me forcë të popullsisë kosovare nga trojet e tyre në drejtim të Shqipërisë dhe të vendeve të tjera fqinje. Numri i të shpërngulurve në Shqipëri shumë shpejt arriti në rreth 500 mijë vetë, që vlerësohet të jenë rreth 15 për qind e popullsisë aktuale që jeton në Shqipëri, dhe u shoqërua nga një varg ndikimesh në bilancin e pagesave.

Pjesa më e madhe e popullsisë kosovare qëndroi në Shqipëri deri në mes të muajit korrik, kur mbaroi konflikti. Popullsia kosovare gjatë qëndrimit në Shqipëri ka blerë mallra e shërbime mbi ndihmat e përfituara duke u

¹⁶ Këtu është përjashtuar efekti i ndryshimit nga kursi i këmbimit.

shndërruar në një burim të fuqishëm mjete valutore për përmasat e tregut shqiptar. Sipas vlerësimeve të Bankës së Shqipërisë¹⁷, shpenzimi ditor për një person arrin në 2.5 marka gjermane në ditë (rreth 1.4 dollarë amerikanë). Si pasojë e këtyre shpenzimeve ditore, vetëm gjatë qëndrimit në Shqipëri, të shpërngulurit vlerësohet se kanë injektuar në ekonominë shqiptare rreth 80 milionë dollarë amerikanë në formën e *cash*-it (valutë fizike). Kriza kosovare tërhoqi në Shqipëri, komunitetin ndërkombëtar, median botërore, organizatat ndërkombëtare, agjenci ndihmash humanitare, trupa ushtarake, shpenzimet e të cilave kanë luajtur një rol të rëndësishëm në financimin e kostos së krizës humanitare dhe në rritjen e të ardhurave korente, kryesisht në shërbimet e turizmit e ato qeveritare. Kriza kosovare (e cila përfshin ndihma ndërkombëtare për popullsinë kosovare dhe prezencën e komunitetit ndërkombëtar) vlerësohet se ka dhënë një efekt total financimi me rreth 300 milionë dollarë për ekonominë shqiptare në formën e të ardhurave nga turizmi, transfertave korente e atyre kapitale, shërbimeve qeveritare etj., shifër e cila është e krahasueshme me të ardhurat vjetore nga dërgesat e emigrantëve shqiptarë. Efektet kryesore të këtyre flukseve në sektorin e jashtëm të ekonomisë kanë qenë:

* hyrjet e larta në mjete valutore, kanë siguruar vlerësimin e vazhdueshëm të Lekut shqiptar kundrejt valutave të huaja gjatë gjithë vitit 1999. Kjo ka dhënë efekt edhe në inflancion;

* janë rritur në mënyrë të konsiderueshme të ardhurat nga shërbimet, veçanërisht të ardhurat nga shërbimet e turizmit;

* rritja e menjëhershme e numrit të popullsisë u shoqërua nga rritja e kërkesës së brendshme, e cila u reflektua në rritjen e madhe të importeve kryesisht për mallrat e konsumit;

* gjatë vitit u regjistrua një rritje shumë e madhe në transfertat korente kryesisht ndihmat në *cash*, në mallra e ato kapitale;

* hyrjet e mëdha në mjete valutore në formën e ndihmave në *cash* dhe kredive, kanë çuar në rritjen e menjëhershme të rezervave valutore.

7.2 Administrimi i rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë.

Gjatë vitit 1999, niveli i rezervës valutore të Bankës së Shqipërisë ka pasur tendencë të vazhdueshme rritjeje. Në fillim të vitit 1999, rezerva valutore vlerësohej 384 milionë dollarë amerikanë ndërsa, në fund të tij, vlera e saj ishte 481 milionë dollarë amerikanë, duke regjistruar një rritje prej 97 milionë dollarë amerikanë, ose afërsisht 25.3 për qind.

Ndër faktorët që kanë favorizuar këtë rritje, përmendim:

- ◆ hyrje të valutës si rezultat i disbursimeve të huaja, në formën e granteve dhe të huave;
- ◆ hyrje nga interesat e investimeve të rezervës valutore;
- ◆ transferime në favor të Bankës së Shqipërisë nga sistemi bankar.

Krahas tyre, ka patur edhe faktorë që kanë ndikuar frenimin e kësaj rritjeje, ku përmendim:

- ◆ vlerësimin e monedhës amerikane në tregun ndërkombëtar;
- ◆ pagesat e borxhit të jashtëm;

¹⁷ Banka e Shqipërisë ndërmorri një vërtetim statistikor me të shpërngulurit nga Kosova. Konkluzionet e paraqitura në box 11 bazohen në rezultatet e këtij vërtetimi.

- ◆ transferime në favor të sistemit bankar.

Në përputhje me politikën e administrimit të rezervës valutore, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i saj, Banka e Shqipërisë ka vazhduar të investojë rezervën valutore në instrumente financiare që garantojnë sigurinë e saj, elementet e dëshiruara të likuiditetit dhe kthimin nga investimi në nivele të kënaqshme. Për të pasqyruar zhvillime të rëndësishme në tregjet ndërkombëtare financiare si edhe për të rritur shkallën e fleksibilitetit në administrimin e rezervës, me vendim të këshillit mbikëqyrës, kjo politikë pësoi disa ndryshime. Kështu, për të pasqyruar prezantimin e monedhes europiane (Euro), u kryen ndryshimet në objektivat për pozicionin e hapur sipas valutave. Marka gjermane dhe lireta italiane u shkrinë në Euro. Gjithashtu, u rrit afati maksimal i investimit në bono thesari të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga 9 në 12 muaj, si edhe u lejua investimi në obligacione të Qeverisë së Greqisë, për të mbuluar riskun e normës së interesit në kuadrin e kredisë greke.

Duke konsideruar gjithmonë primar kontrollin dhe menaxhimin e risqeve që shoqërojnë investimin e rezervës valutore, përmirësimi i mëtejshëm i politikës së administrimit të saj përbën një nga detyrat e Bankës së Shqipërisë, e cila kërkon zgjidhje gjatë vitit 2000.